



المؤسسة الإسلامية للشباب

Fondazioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth

Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
☎ + 41 (0) 43 300 16 70

www.islamischen.ch
✉ Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

N ë emër të A ll-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

DEKLARATA ISLAME

Alija Izetbegoviq

Botuar nga: SHB Logos-A

Të gjitha të drejtat e këtij libri i takojnë botuesit

PRAPAMBETURIA E POPUJVE MUSLIMANË	9
KONSERVATORËT DHE MODERNISTËT	9
SHKAQET E DOBËSISË	16
INDIFERENDITETI I MASËS MUSLIMANE	22
II. RREGULLIMI ISLAM	25
FEJA DHE LIGJI	25
ISLAMI NUK ËSHTË VETËM RELIGJION	28
RREGULLIMI ISLAM I KOHËS SONË - TEZAT	30
(NJERIU DHE BASHKËSIA)	31
(BARABARËSIA E NJERËZVE)	32
(VËLLAZËRIMI I MUSLIMANËVE)	33
(UNITETI I MUSLIMANËVE)	34
(PRONËSIA)	34
(ZEKATI DHE KAMATA)	36
(PARIMI REPUBLIKAN)	37
(NUK KA HYJNI TJERA PERVEÇ ALL-LLAHUT)	37
(EDUKATA)	38
(ARSI/MI)	39
(LIRIA E NDËRGJEGJES)	40
(ISLAMI DHE PAVARËSIA)	41

(PUNA DHE LUFTA).....	43
(GRUAJA DHE FAMILJA).....	44
(CAKU NUK ARSYETON MJETIN).....	46
(PAKICAT).....	47
(MARËDHËNIET NDAJ BASHKËSIVE TJERA)	48
PROBLEMET E RREGULLIMIT ISLAM SOT	48
RILINDJA ISLAME- REVOLUCION FETAR APO POLITIK?	48
PUSHTETI ISLAM	53
PAKISTANI - REPUBLIK ISLAME	54
PANISLAMIZMI DHE NACIONALIZMI	57
KRISHTERIZMI DHE HEBRAIZMI	64
KAPITALIZMI DHE SOCIALIZMI.....	66
PËRMBYLJE.....	71

Në emër të All-llahut, të Gjithmëshirmit, Mëshirplotit!

Dekleratën të cilën sot po ia dorëzojmë opinionit nuk është kurrfarë lektyre, e cila të huajve ose atyre të cilët dyshojnë duhet dëshmuar superioritetin e Islamit ndaj këtij apo atij sistemi, kësaj apo asaj grupe të ideve.

Ajo iu është drejtuar muslimanëve të cilët dinë ku bëjnë pjesë dhe të cilët në zemrën e tyre qartë ndiejnë në cilën anë qëndrojnë. Për të këtillët kjo deklaratë paraqet thirrje t'i nxjerrin konsekuencat e domosdoshme mbi atë në çka ajo dashuri dhe përkatësi i obligon.

Tërë bota muslimane gjendet në situatën e vlimeve dhe ndryshimeve. Si do që të duket kjo botë pasi këto ndryshime ta bëjnë xhiron e parë ngjitetë, një është e sigurt: ajo më nuk do të jetë bota nga gjysma e parë e këtij shekulli. Epoka e pasivitetit dhe qetësisë kaloi përgjithmonë.

Këtë çast të ndërrimit dhe lëvizjes po përpiqen ta shfrytëzojnë të gjithë e sidomos të huat e fuqishëm nga Lindja dhe Perëndimi. Në vend të ushtrive të tyre ata tash i fusin idetë e tyre dhe kapitalin e tyre, dhe me këtë formë të re të ndikimit orvaten sërish ta arrijnë qëllimin e njëjtë: ta sigurojnë praninë e tyre dhe që popujt muslimanë t'i mbajnë edhe më tej në gjendjen e dobësisë shpirtërore dhe varshmërisë materiale dhe politike.

Kina, Rusia dhe vendet perëndimore grinden rreth asaj se cilën prej tyre dhe mbi cilën pjesë të botës muslimane u takon patronati. Grindja e tyre është e pakuptimtë. Bota Islamike nuk u përket atyre, por popujve muslimanë.

Sepse, një botë me një miliardë njerëz dhe me burime të mëdha natyrale dhe në rendin e parë të pozitës gjeografike, e cila është trashëgimtare e traditave kolosale kulturore dhe politike dhe e cila është bartëse e mendimit të gjallë islamik, kjo botë nuk mundet shumë kohë të mbetet në pozitën e qiradhënesit. Nuk ekziston fuqi e cila do të mund ta pengonte gjeneratën e re muslimane që ta ndërprejë këtë gjendje jonormale.

Me këtë bindje ne u shpallim miqëve dhe armiqëve se muslimanët kanë vendosur që fatin e botës muslimane ta marrin në duart e vetadhe këtë botë ta rregullojnë sipas botëkuptimeve të tyre.

Në këtë pikëpamje deklarata nuk përmban ide të cilat do të mund të konsideroheshin plotësisht të reja. Ajo më parë është sintezë e ideve të cilat gjithnjë e më shpesh po dëgjohen në vendet e ndryshme dhe të cilat kanë përafërsisht rëndësinë e përgjithshme në të gjitha pjesët e botës muslimane. Megjithatë, risia e saj është në atë që kërkon që nga idetë dhe planet të kalohet në aksion të organizuar për sendërtimin e tyre.

Lufta për qëllimet e reja nuk fillon sot. Përkundrazi historia e kësaj lufte tashmë i njeh shëhidët e vet dhe faqet e shkruara mbi vuajtjet dhe sakrificat. Megjithatë, ky është flijim vetjak i individëve të pikasur ose i grupeve të vogla guximtare në ballafaqim me fuqitë e fuqishme të xhahilitit. Madhësia e problemit dhe e vuajtjeve, ndërkaq kërkon aksion të organizuar të milionave.

Porosinë tonë ia përkushtojmë kujtimit të shokëve tonë të cilët kanë rënë për Islam.

-A duam që popujt muslimanë të dalin nga të lëvizurit në rreth, nga varshmëria, prapambeturia dhe varfëria.

-A duam që sërish me hapa të sigurtë të ecin në shtigjet e denjësisë dhe arsimit dhe të bëhen zotëri të fatit të tyre;

-A duam që sërish me tërë forcën të gufojnë burimet e trimërisë, gjenive dhe të virtytëve;

Atëherë qart të tregojmë në rrugën e cila shpie deri të ai synim;

Sendërtimi i Islamit në të gjitha fushat në jetën vetjake të individëve, në familje dhe shoqëri, nëpërmjet përtërtjes së mendimit fetar Islam dhe krijimit të bashkësisë unike Islame prej Marokus deri në Indonezi.

Ky synim mund të duket edhe i pamundur edhe i largët, por ai është real, sepse vetëm ai gjendet në suazat e së mundshmes. Përkundrazi. Çdo program joislamik në sy mund të duket i afërt dhe në prag të caktit, por ai për botën islame është utopi e pastërt, sepse qëndron në suazat e së pamundshmes.

Historia tregon faktin e qartë: Islami është mendimi i vetëm i cili ka mund ta mallëngjëjë imagjinatën e popujve muslimanë dhe të arrijë te ata masën e domosdoshme të disiplinës, frymëzimit dhe energjisë. Asnjë ideal tjetër, i huaj për Islam, kurrë nuk ka arritur të realizojë çfarëdo efekti me rëndësi as në fushën e kulturës e as në fushën e shtetit. Në të vërtetë, çdo gjë që në historinë e popujve muslimanë është e madhe dhe me vlerë të përmendet, është krijuar nën shenjën e Islamit. Vetëm disa mijëra luftëtarë të mirëfilltë islamik e kanë detyruar Anglinë që viteve të pesëdhjeta të këtij shekulli të tërhiqet nga Suez, kurse ushtritë e bashkuara të regjimeve nacionaliste arabe tash për herë të tretë po e humbin betejën kundër Izraelit. Turqia si vend islam

e ka sunduar botën. Turqia si plagjiat evropjan paraqet vend të dorës së tretë, çfarë në botë ka me qindra.

Populkli sikur edhe individi, i cili e ka pranuar Islamin është i paaftë që pas kësaj të jetojë dhe vdesë për çfarëdo ideali tjetër. S'është e marrur me mend që muslimani të sakrifkohet për ndonjë mbret ose sundues, si do që të quhet ai, ose për lavdi të ndonjë kombi, partie ose diç të ngjajshme, sepse sipas instinktit më të fortë islam ai në këtë e njehë një lloj të jobesimit dhe idhujtarisë. Muslimani mund të vdesë vetëm me emrin e All-llahut dhe për lavdi të Islamit ose – të ik nga fushëbeteja.

Sandejmi, periodatat e pasivitetit dhe stagnimit në të vërtetë dmth. Mungesa e alternativës Islame ose papërgatitshmërisë së mjedisit muslimanë që të drejtohet kah ky shteg i përjetshëm. Ato janë shprehje negative e monopolit shpirtërorë të cilin Islami e ka mbi botën muslimane.

Duke e pranuar këtë gjendje si shprehje të vullnetit të Allahut, ne pohojmë qartë se bota Islame nuk mund të rimëkëmbët pa dhe kundër Islamit. Islami dhe parimet e tij mbi vendin e njeriut në botë, qëllimit të jetës së njeriut dhe raporteve ndërmjet njeriut njeriut dhe Zotit dhe njeriut dhe njeriut vmbesin fundament i përhershëm dhe i pa zëvendësueshëm etik, fillozofik, ideor dhe politik i çdo aksioni të mirëfilltë në drejtëm të rimëkëmbjes dhe përmirësimit të gjendjes së popujve muslimnë.

Alternativa është e qartë:

ose lëvizja në drejtim të rimëkëmbjes Islame

ose pasiviteti dhe stagnimi

Për popujt muslimanë mundësi e tretë nuk ekziston.

PRAPAMBETURIA E POPUJVE MUSLIMANË KONSERVATORËT DHE MODERNISTËT

Ideja e rimëkëmbjes islame, me botëkuptimin e saj mbi aftësitë e Islamit që jo vetëm ta edukojë njeriun por edhe ta rregullojë botën, do të ketë gjithnjë armiçë në dy grupe njerëzish: konservatorët dëshirojnë modelet e vjetra, modernistët dëshirojnë modelet e huaja. Të parët Islamit e tërheqin në të kaluarën, të dytët ia përgatisin ardhmërinë e huaj.

Pa marrë parasysh në dallimet mjaft të mëdha reciproke, këto dy kategori njerëzish kanë diç të përbashkët: edhe të parët edhe të dytët në Islam shohin vetëm religjionin, duke e kuptuar këtë shprehje në kuptimin evropian të kësaj fjale. Mungesa e caktuar e prirjes për hollësitë e gjuhës dhe logjikës, kurse më shumë të moskuptuarit e thelbit të Islamit dhe rolit të tij në histori dhe botë, i shpie që dinin islam ta përkthejnë me religion çka për shkak të një arsyeje të veçantë është krcjtësisht e gabueshme.

Edhe pse paraqet përsëritje dhe konfirmim të të vërtetave fundamentale m) i prejardhjen dhe misionin e njeriut, të hyrët Islamit në një gjë është plotësisht e re: në kërkesën që të bashkohet feja dhe shkenca, morali dhe politika, ideali dhe interesi. Duke i pranuar të ekzistuarit e dy botërave, natyrale dhe të brendshme, Islami mëson se pikërisht njeriu paraqet kalim të humnerës

ndërmiet këtyre dy botërave. Jashtë këtij uniteti rligioni fillon të tërhq në prapambeturi (rcfuzimi i çdo jete vcrucse), kurse shkenca në ateizëm.

Duke u nisur nga qëndrimi se Islami është vctëm religion, konservatorët vijnë në përfundim se Islami nuk duhet, kurse progrcsistët se Islami nuk mundet ta rregullojë botën e jashtme. Rezultati praktik është i njëjtë.

Bartësi kryesor, ndonëse jo edhe i vetmi, i botëkuptimit konservativ në botën muslimane sot është klasa e hoxhëve dhe shejhëve, të cilët përkundër qëndrimeve të qarta mbi mosekzistimin e klerit (priftërisë) në Islam, janë organizuar si klasë e veçant, i cili për vcte e ka monopolizuar të komentuarit e Islamit dhe është vënë si ndërmjetësues ndërmjct Kur'anit dhe njerëzve. Si priftërinj ata janë teologë, si tcologë ata janë pashmangshëm dogmatikë dhe, pasi që fcja përgjithmonë edhe është komentuar, dhe më së miri është të lihr-t tërësisht si është dhënë dhe definuar dhe para njëmijë c më shumë viteve. Sipas kësaj logjike të pashmangshme të dogmatikëve, tcologët bëhen armiçë të rreptë kundër çdo gjëje të re. Ndërtimi i mëtejshëm i sheriatit si ligj në kuptim të aplikimit të parimeve të Kur'anit për situatat gjithnjë e më të reja të cilat i sjell zhvillimi i botës barazohct nie atakun në integritetin e fcsë. Mbase në këtë ka edhe dashuri patologjike e njerëzve shpirtngusht dhe të prapainbetur, përçarimi i vdekjes i së cilit pothuaj e ka asriksuar mendimin edhe më të gjallë islam.

Do të ishte ndërkaq gabim të mendohet që në duart e tcologëve Islami ka mbetur liber i mbyllur. Gjithnjë çdo herë e më shumë e mbyllur ndaj shkencës dhe gjithnjë çdo herë e më shumë e hapur ndaj mistikës, teologjia ka lejuar që në këtë libër të regjistrohcn gjera irracionale, për mësimin islam plotësisht të huaja e madje edhe bestytyni të qarta. Kush e njeh natyrën e teologjisë do t'i

bëhet e qartë pse ajo nuk ka mund t'i kundërvihet sprovës së mitologjisë dhe përse madje në këtë ka shikuar në të pasuruarit e caktuar të mendimit fetar. Monoteizmi i Kur'anit, më i pastërti dhe më i përkryeri në historinë e mësimëve fetare, ka qenë shkallërisht i komprometuar, kurse në praktikë është paraqitur tregtia neveritëse me fenë. Ata të cilët veten e kanë quajtur komentues dhe mbrojtës të fesë, nga ajo kanë bërë profesion, përndryshe mjaft i këndshëm dhe i leverdishëm, dhe pa shumë brçitje të ndërgjegjes kanë pranuar gjendjen në të cilën porositë e saj fare nuk janë aplikuar.

Teologët kështu janë bërë njëri prej të gabueshëm në vendin e gabueshëm. Edhe tash kur bota muslimane po tregon të gjitha shenjat e zgjimit, kjo shtresë po bëhet shprehje e çdo gjëje të kobshme dhe sklerotike në atë botë. Ajo është treguar plotësisht e paafte ta errë çfarëdo hapi konstruktiv që bota islame të ballafaqohet me vështirësitë të cilat po e shtrëngojnë.

Sa u përket ta ashtuquajturëve progresistëve, përëndimorëve, modernistëve dhe si më nuk quhen, ata kudo në botën muslimane paraqesin mjerim të vërtetë, sepse janë mjaft të numërt dhe me ndikim, sidomos në pushtet, arsim dhe jetën publike përgjithësisht. Duke shikuar Islamin të hoxhët dhe konservatorët dhe duke i bindur të tjerët në këtë, modernistët frontalisht ngriten kundër çdo gjëje çka e prezenton këtë mendim. Këta reformatorë të vctëthirrur në vendet e sotme muslimane do t'i njihni sipas asaj që rëndom mburren me atë prej së cilës do të duhej të turpëroheshin dhe turpërohen prej asaj me të cilën do të duhej të mburreshin. Në rastet e shumta këta janë "bijtë e babajve", të cilët shkollohen në Evropë dhe nga aty kthehen me ndjenjën e inferioritetit të thellë ndaj Perëndimit të pasur dhe superioritetit të veçant ndaj mjedisit të varfër e të prapambetur nga i cili kanë lindur. Pa edukatë islame dhe pa lidhjen shpirtërore dhe morale me popullin, ata shpejt i humbin kriteret elementare, dhe imaginons se me rrënimin e botëkuptimeve,

traditave dhe bindjeve të vendit, kurse me futjen e të huajave, në këtë vend gjatë natës do ta krijojnë Amerikën, së cilës përndryshe për së tepërnë i admirohen. Në vend të standardit ata sjellin kultin e standardit, në vend të zhvillimit të mundësive të asaj bote, ata i zhvillojnë dëshirat dhe kështu ia hapin rrugën korrupsionit, primitivizmit dhe kaosit moral. Atyre s'u është e qartë që fuqia e botës perëndimore nuk është në atë si jeton ai, por në atë si e punon ai, që ajo fuqi nuk është në modë, jobesim, klubet e natës, brezin e ri të shkapërderdhur, por në aktivitetin, zellshmërinë, diturinë dhe përgjegjësinë e jashtëzakonshme të njerëzve të tij.

Nuk është, pra, fatkeqësia kryesore në atë që perëndiitorët tonë i kanë shfrytëzuar moduset e huaja, por në atë që nuk kanë ditur t'i shfrytëzojnë ose - thënë më mirë - që gjatë kësaj nuk e kanë zhvilluar sa duhet ndjenjën e fuqishme për atë çka lvinë. Ata nuk e kanë marrë prodhimin e dobishëm, por mosproduktin e dëmshëm, asfiksues të një procesi të civilizimit.

Ndër rekuizitet e vlerës së dyshimtë të cilat përcëndimori ynë i futë në shtëpi, gjenden rëndom edhe idetë e ndryshme "revolucionare", programet e reformës dhe "doktrina shpëtuese" të ngjashme të cilat i "zgjodhin të gjitha problemet". Ndër këto reformat ka shembuj të shkurtpamësisë dhe improvizimit të pabesueshëm. Kështu, për shembull, Mustafa Kemal, i cili qartë ka qenë komandant lufte më i madh se sa reformator kulturor dhe meritat e të cilit për Turqinë duhet shpjerë në masën e duhur, me një nga reformat e tij ndalon bajtjen e fesit. U tregua shumë shpejtë se me ndërrimin e formës së kapelës nuk mund të ndërrohet ajo që është në kokat ose shprchitë e njerëzve, e edhe më pak ajo çka e përbënë pozitën e tyre të vërtetë, prandaj të gjitha problemet e Turqëve, të djeshme në les dhe të sotme në sheshir, kanë mbetur plotësisht të njëjta.

Tashmë më shumë se një shekull para shumë popujve jashtë sferës së civilizimit përcëdimor, shtrohet problemi i marrëdhënieve ndaj këtij civilizimi. A të merret në këtë ballafaqim qëndrimi i refuzimit të plotë, përshtatjes duke pasur kujdes apo të pranuarit e të gjitha aspekteve të këtij civilizimi pa zgjidhje?- Tragjedia apo triumfi i shumë popujve ka qenë varësisht nga ajo se si janë përgjigjur ata në këtë pyetje vendimtare.

Ekzistojnë reforma nga të cilat shkëlqeu urtësia e një populli dhe ato të cilat dtt. tradhëti të vctëvetes. Shembulli i Japonisë dhe Turqisë në këtë aspekt mbetet klasik në historinë bashkëkohore.

Kah fundi i shekullit të shkuar dhe fillimi i këtij shekulli këto dy vende kanë ofruar fotografinë e vendeve mjaft të ngjashme "të krahasueshme". Te dyja kanë qenë mbretëri të vjetra, me fizionomi vetjake dhe me vendin e tyre në histori. Të dyja janë gjendur në afërsisht shkallën e njëjtë të zhvillimit edhe me të kaluarëti e lavdishme e cila ka mund të ketë domethënie edhe privilegji i madh edhe barrë e madhe. Me një fjalë, ato për ardhmërinë kanë pasur pothuaj gjasa të barabarta.

Pastaj kanë pasuar reformat e njohu ,a në të dy vendet. Që të vazhdojë tajetojë jetën e vet, ejo të huaj. Japonia ka tentuar t'i unjësojë traditat dhe progresin. Për Turqinë modernistët e saj e kanë zgjedhur rrugën e kundërt. Sot Turqia është vend i dorës së tretë, ndërsa Japonia ka hipur m'u në kulm të popujve të botës.

Dallimi në filozorinë e reformatorëve j aponezë dhe turqë mbase nuk ka qenë askund aq i qartë dhe karakteristik sikur në pyetjen e alfabetit.

Deri sa Turqia e ka alfabetin arab, i cili për shkak të thjeshtësisë së tij dhe vëtëm me 28 shenja, bënë pjesë në alfabetet më të përkryera dhe më të zgjeruara botërore, Japonia refuzon kërkesën e "romajëve" të vet ta fusë alfabetin latin. Ajo mbajti alfabetin e vet të komplikuar i cifi pas reformës ërve 46 she 'ave përmbanë edhe 880 ideograme kineze. Në Japoni sot nuk ka analfabetë, kurse në Turqi - dyzet vjet pas futjes së latinishtës - analfabetë janë më shumë se gjysma e popullësisë, një rezultat nga i cili, pra, edhe të verbërit do të duhej të shikonin.

Dhe jo vetëm kjo. Së shpejti u bë e qartë se nuk ka qenë në pyetje vetëm alfabeti si mjet i thatë i regjistrimit. Shkaqet e vërteta, e pastaj edhe pasojat, janë shumë më të thella dhe më të rëndësishme. Esenca e tërë civilizimit dhe progresit njerëzor është në vazhdimin, e jo në shkatërrim dhe mohim. Alfabeti është mënyrë në të cilin populli "mbanë mend" dhe jeton në histori. Me heqjen e alfabetit arab tërë pasuria e të katuarës, e ruajtur me fjalën e shkruar për Turqinë ka qenë kryesisht e humbur dhe ajo me këtë një të vetmin potez është nënçmuar deri te kufinjt e barbaritetit. Pranë një sërë reformash tjera "paralele", gjenerata e re turke u gjetë , pa mbështetje shpirtërore dhe në një lloj vakumi shpirtëror - Turqia i ka humbur "kujtimet" e saja, të kaluarën e saj. Kujt i është nevojitur kjo?

Ithtarët e modernizmit në botën islame nuk, kanë qenë, pra, ai Hoj i njerëzve të urtë popullor, të cilët kanë ditur në rrethanat e ndërruara dhe në mënyrë të re t'i realizojnë idealet dhe vlerat e %jetra. Ata janë ngritur kundër vetë vlerave dhe shpesh me cinizmin e ftohtë dhe shkurtëpamësinë e tmerrshme i kanë shkelur shenjtëritë popullore dhe e kanë shkatërruar jetën reale, që në vend të saj ta transplantojnë imitimin ejetës. Si pasojë e këtij egërsimi në Turqi dhe rië vende të tjera janë krijuar, ose janë në rrugë të krijohen, popujtrplagiate: vendet shpirtërisht të tollovitura pa fizionomi vetjake dhe pa ndjenjë për jetën e vet vetjake. Në ta çdo gjë është

joautentike dhe artificialisht pa entuziazëm dhe fuqi të vërtetë, sipas shembullit të shkëlqimit të rrejshëm të qyteteve të tyre të evropëizuar.

A mundet vendi i cili nuk di ç'është dhe prej kah i tërheq rrënjët, ta ketë pasqyrën e pastërt mbi atë ku po shkonë dhe kah duhet të synojë?

Shembulli i disa reformave të Kemalit mund të duket drastik, por sidoqoftë këto reforma paraqesin model për çdo hyrje të perëndimorit problemeve të botës islame dhe mënyrës në të cilën ata mendojnë ta "riparojnë" këtë botë. Kjo gjithnjë është tjetërsim, ikje nga problemet e vërteta, prej punës së mundimshme në ngritjen e vërtetë morale dhe arsimore të popullit dhe orientimi në gjërat e jashtme, sipërfaqësore. Ç'kuptim ka pasur pavarësia e një vendi musliman në të cilën udhëheqja e punëve publike ka ardhur në duart e këtij Iloji të njerëzve? Si e kanë përdorë ata këtë liri?

Me të pranuarit e shembujve të huaj ideor dhe me të kërkuarit e mbështetjes politike tek të huajt, atyre në Perëndim ose atyre në Lindje - njëjtë, çdonjëra nga këto vendet vullnetarisht në gojën e sunduesve të vet të rinj, ka pranuar në robërimin e sërishëm. Është krijuar një lloj i varshmërisë shpirtërore dhe materiale, përmbajtja e së cilës është: filozofia e huaj, mënyra e huaj e jetës, ndihma e huaj, kapitali i huaj, mbështetja e huaj. Këto vende kanë arritur pavarësinë formale, por nuk e kanë arritur lirinë e vërtetë, sepse çdo liri pikë së pari është liri shpirtërore. Pavarësia e popujve i cili së pari nuk e ka arritur këtë liri shpirtërore, së shpejti do të shpjeret në himnë dhe flamur, kurse këto dy gjera janë shumë pak për pavarësinë e vërtetë.

Lufta për pavarësinë e vërtetë të popujve muslimanë duhet pa tjetër për këtë shkak çdokund të fillojë sërish.

SHKAQET E DOBËSISË

Këto dy llojet e njerëzve - konservatorët dhe modernistët, paraqesin çelës për të kuptuarit e gjendjes së tashme të popujve muslimanë. Megjithatë, ata nuk janë shkaku i vërtetë dhe i fundit i kësaj gjendjeje. Në analizën e mëtejme, edhe ajo edhe kjo gjendje tregohen vetëm si shprehje dhe manifestim i një shkaku më të thellë: degradimit apo refuzimit të mendimit islam.

Historia e Islamit nuk është, e madje as në pjesën e vet më të madhe, vetëm histori e realizimit progresiv të Islamit në jetën e njëmendët. Ajo po aq është edhe kallëzim mbi të moskuptuarit, mospërrillurit, mashtrimit dhe të keqpërdorurit të këtij mendimi. Sandeimi edhe historia e çdo populli muslimanë njëkohësisht është edhe kronologjia e të arriturave dhe fitoreve të shëndritshme, sa edhe e lajthitjeve dhe humbjeve pikëlluese. Të gjitha sukseset dhe mosukseset tona, politike sikur edhe morale, në të vërtetë janë vetëm shprehje e pranimit tonë të Islamit dhe aplikimit të tij në jetë. Dobësimi i ndikimit të Islamit në jetën praktike të popullit, gjithmonë ka qenë i përcjellur me degradimin e njeriut dhe institucioneve shoqërore dhe politike.

Tërë historia e Islamit, prej fillimeve të para deri në ditët tona, është zhvilluar nën ndikimin - e paepur të kësaj coincidence. Në këtë "paraelizëm" gjendet diç nga fati i pandryshueshëm i popujve muslimanë dhe një nga ligjet e historisë islame.

Dy çastet karakteristike nga historia e Islamit - njëri nga perioda e ngritjes, tjetri nga perioda e dekadencës - munden mjaft qartë ta ilustrojnë veprimin e këtij ligji.

Muhammedi a.s. vdiq në vitin 632, kurse jo plotë 100 pas kësaj pushteti shpirtëror dhe politik i Islamit ka përfshirë territor të madh prej Oqeanit Atlantik deri te lumi Ind dhe Kina, dhe prej

liqenit Aral deri te ujëvaret e poshtme të Nilit. Siria është pushtuar më 634, Damasku ka rënë më 635, Ktesifoni më 637, India dhe Egjipti më 641, Kartagiena më 647, Samerkandi më 676, Spanja më 710. Para Carigradit muslimanët kanë qenë më 717, kurse më 720 në Francën Jugore. Duke filluar nga viti 700 në Shantung tashmë ekzistojnë xhamitë, kurse rreth vitit 830 Islami arriti në Javë.

... Ky ekspansion unik, me të cilin nuk mund të krahasohet asnje, as më herët as më vonë, ka krijuar pastaj hapësirë për zhvillimin e civilizimit islam nga tri qarqe kulturore: në Spanjë, në Lindien e Mesme dhe në Indi, të cilat në histori mbulojnë epokën prej gati njëmijë vjet.

Ç' rëndësi kanë sot në botë muslimanët?

Pyetja do të mund të shtrohej edhe në mënyrë tjetër: Sa jemi ne muslimanë?

Përgjigjet në këto pyetje janë të lidhura reciprokisht.

Ne jemi robëruar: në një çast të vitit 1919 nuk ka ekzistuar asnje vend i pavarur muslimanë, gjendje e cilà nuk është shënuar asnjëherë as më herët as pas kësaj.

Ne jemi të paarsimuar: në asnjë vend muslimanë arsimimi ndërmjet dy luftërave të mëdha botërore nuk ka qenë më shumë se 50%. Pakistani e ka pritur pavarësinë me 75% analfabetë, Algeria me 80%, kurse Nigjeria me plotë 90%. (Përkundër kësaj, në Spanjën muslimane të shekullit X dhe XI - sipas Dreperit - nuk ka pasur analfabetë).

Ne jemi të varfër: të ardhurat nationale për banorë janë: në Iran 220 dollarë, në Turqi 240, në Malajzi 250, në Pakistan 90, në Afganistan 85, në Indonezi 70, kundruall 3000- në USA (gjendja

më 1966). Pjesa e sektorit industrial në të ardhurat nationale të shumicës së vendeve muslimane është ndërmjet 10 e 20%. Numri i kalorive në ushqimin e përditshëm mesatarisht është 2000 kundruall 3000-3500 në vendet e Evropës Perëndimore.

Ne jemi bashkësi e ndarë: në vend që të jetë shoqëri pa mjerim dhe pa luks, shoqëria muslimane është shndërruar në kundërshtinë e vet. Kundër urdhërit kur'anor: "... që kjo pasuri (e mirë) mos të mbetet në rrethin e të pasurve midis jush" (Kur'an, 39,7) pasuritë shkallërisht janë akumuluar në duart e pakicës nga ata. Para reformës agrare në Irak në vitin 1958, prej milionë dynymë të tokës së ' punueshme, rreth 18 milionë dynymë ose 82% e kanë mbajtur pronarët e mëdhenj. Njëkohësisht 1.4 milionë fshatarë kanë qenë krejtësisht pa tokë.

Kjo është ajo gjendje të cilën disa me të gjitha shkaqet e kanë quajtur "nata e Islamit". Në të vërtetë, ajo natë ka filluar si muzgë në zemrat tona. Tërë ajo që na ka ndodhur ose sot po na ndodh, është vetëm jehonë dhe përsëritje e asaj që para kësaj ka ndodhur në vetë ne. (Kur'anî, 13, 12).

Sepse, ne si muslimanë nuk mund të jemi nën zgjedhë, të paarsimuar të ngatërruar. Ne këtë mund të jemi vetëm si heretikë nga Islami. Të gjitha humbjet tona, prej asaj të parës në Uhud e deri te ky i fundit në Sinaj, barabartë e konfirmojnë këtë qëndrim.

Fenomeni i lëshimit të Islamit, më së shpeshti i shprehur në të shtëmëngurit e mendimit islam nga sfera e jetës vepruese dhe të zgjuar në sferën e çastit dhe pasivitetit, më së qarti mund të përcillet pikërisht në shembullin e Kur'anit, si faktin qendror të ideologjisë dhe praktikës islame.

Duhet vërejtur, se si çdo ngritje e popujve islam, çdo periodë e dinjitetit, ka filluar me afirmimin e Kur'anit. Ekspansioni i islamit të hershëm, zhvillimin e çuditshëm të të cilit këtu e kemi përmendur dhe i cili gjatë dy brezeve Islamit e solli deri te brigjet e oqeanit Ailantik në perëndim dhe deri te Kina në lindje, nuk, paraqet shembullin e vetëm, por vetëm më të lavdishëm. Të gjitha lëvizjet e mëdha në rrjedhën e historisë islame e konfirmojnë këtë ligj të paralelizmit.

Çfarë ka qenë pozita e Kur'anit në kohën e cila i ka paraprirë periodës së Stagnimit dhe tërheqjes?

Lojaliteti ndaj këtij libri nuk është ndërprerë, por e ka humbur karakterin aktiv, kurse e ka mbajtur atë irracional, mistik. Kur'ani e ka humb autoritetin e ligj it, kurse e ka pranuar "shenjtshmërinë" e lëndës. Në të hulumtuarit dhe të komentuarit e tij urtësia ia ka lëshuar vendin të kërkuarit halë në përpeq, esenca formës, kurse mendimet e mëdha shkathësisë së të recituarit. Nën ndikimin e përhershëm të formalizimit teologjik Kur'ani gjithnjë e më pak lexohej, kurse gjithnjë e më shumë këndohej (recitohej), kurse urdhërat mbi luftën, korrektësinë dhe mbi sakrifikimin personal dhe material, të vathta dhe jo të këndshme për inercionin tonë, janë tretur dhe janë zhdukur në zërin e këndshëm të tekstit të lexuar të Kur'anit. Kjo gjendjejo e natyrshme shkallërisht është pranuar si normale, sepse i përgjigjei atij grupit gjithnjë e më të numërt të muslimanëve, i cili as që ka mundur të ndahet me Kur'anin, as që ka pasur fuqi që jetën e tij ta rregullojë sipas kërkesave të tij.

Në këtë fakt duhet kërkuar shpjegim psikologjik për shfaqjen e të recituarit të tepruar të Kur'anit. Kur'anin e recitojnë, e komentojnë dhe e recitojnë, e studiojnë dhe sërish e recitojnë. E përsërisin nga njëmyë herë një rjal ' i të tij, që mos të munden as një të vetmen berë ta aplikojnë. Kanë krijuar dituri të gjerë e pedante mbi atë se si shqiptohet Kur'ani, që të shmangen nga pyetja se si

ta aplikojnë në jetë. Në fund, Kur'anin e kanë shndërruar në zë të zhveshurr pa domethënie dhe përmbajtje të kuptueshme.

Tërë njëmendësia e botës muslimane me mospajtimin e vet ndërmjet fjalës dhe veprës- me çorodinë, ndytësinë, padrejtësinë dhe polltronerinë e vet, me xhamitë e veta monumentale, por të zbrazëta: me ahmeditë e veta të mëdha pa ideal dhe guxim; me frazën hipokrite islame dhe me pozën fetare; me këtë le pa le, është vetëm shprehje e jashtme e kësaj kundërtënie bazore në të cilën është gjetur Kur'ani dhe në të cilën lojaliteti i flaktë ndaj këtij libri shkallërisht është kombinuar me të mohuarit absolut të parimeve të tij në praktikë.

Ja, në këtë situatë me Kur'anin gjendet shkak i parë dhe më i rëndësishëm i mirëfiutë i zbrapjes dhe paaftësisë së popujve muslimanë. Shkak i dytë i këtillë, i cili ka rëndësi univerzale, është shkollimi, respektivisht sistemi edukativ në kuptimin më të gjerë.

Me shekuj popujt tonë edhe nuk kanë njerëz të shkoftuar. Në vend të tyre i kanë dy kategori tjera, barabartë të padëshirueshme: të pashkolluar dhe gabimisht të shkolluar. Në asnjë vend muslimanë ne nuk kemi shkollim i cili do të jetë mjaft i zhvilluar dhe i cili gjatë kësaj i përgjigjej botëkuptimeve morale të Islamit dhe nevojave të popujve. Këtë institucion më të ndijshëm të çdo shoqërie pushtetmbajtësit tonë ose nuk e kanë mospërfdull, ose ia kanë lënë të huajve. Shkollave të cilave të huajt u kanë dhënë para dhe kuadër, e me këtë edhe program edhe ideologji, nuk kanë arsimuar muslimtanë, e madje as nacionalistë. Në to intelektualëve tonë të ardhshëm ua kanë injektuar "virtytet" e dëgjueshmërisë, nënshtrueshmërisë dhe admirimit ndaj fuqisë dhe pasurisë së të huajve; në to edukatorët e huaj krijojnë këtë inteligjencën me mentalitet vazalist, e cita nesër mrekullueshëm do t'i ndërrojë, sepse edhe do të ndibet edhe do të sillet si i huaj i vërtetë në

vendin e tij vetjak. Do të ishte mjaft instruktive të konfirmohet sa është numri i shkollave dhe kolegjeve të cilat, drejtpërdrejt apo tërthorazi, i mbajnë të huajt, dhe të kujtohem mbi shkaqet e kësaj bujarie të jashtëzakonshme. Do të duhej thëlluar në programet e këtyre institucioneve, në atë që ata e përmbajnë e edhe më shumë në atë që ata nuk e përmbajnë. Do të bëhej e qartë që pyetja e mirëfilltë edhe nuk është në atë se a don dhe a ka dëshirë inteligjencia ynë ta gjejë rrugën deri te populli i vet, deri te synimet dhe intereset e tij të mirëfillta, por, ashtu çfarë është, a mundet ajo asses ta gjejë atë rrugë. Ka të bëjë me shkauën e vlerave dhe idealeve, e cita është imponuar dhe mbi jazin psikologjik i cili është krijuar. Nuk nevojiten më zingjirët e hekurt që popujt tonë të mbahen të përkulur. Fuqinë e njëjtë e kanë edhe pejëzat e mëndafshtë të këtij "arsimimi" të huaj, i cili e paralizon vufinetin dhe vtëdijen e pjesës së arsimuar të një populli. Deri sa është një shkohim i tihë pushtetmbajtësit e huaj dhe vazalët e tyre në vendet e tyre nuk duhet frikësuar për pozicionet e tyre. Në vend që të jetë burim i kryengritjes dhe rezistencës kundër tyre, sistemi i tihë shkollor është aleati i tyre më i mirë.

Ky jaz tragjik ndërmjet inteligjencës dhe popullit, i cili paraqet një ndër karakteristikat më të zymta të pozitës sonë të rgjithshme, thellohet edhe nga ana tjetër. Duke e ndër karakterin e huaj dhe joislam të shkollës e cita u ofrohet, populli instinktivisht e refuzon, kurse largimi bëhet i dyanshëm. Konstruktohet akuza absurde mbi antipatinë e mjedisit muslimanë kundruall shkollës dhe arsimit. Në të vërtetë, është e qartë se nuk ka të bëjë me refuzimin e shkollës si të tillë, por me të refuzuarit e shkollës së huaj, e cita me Islamin dhe popullin e ka humb çdo lidhje shpirtërore.

INDIFERENDITETI I MASËS MUSLIMANE

Kthesën të cilën modernistët e kanë kryer në një varg vendesh muslimane pothuaj ka qenë, sipas rregullit, antifetarisht e orientuar dhe është udhëhequr nën parollat e laicizmit të jetës politike dhe shoqërore. Në këtë pikëpamje ai ka përkujtuar në luftën ndërmjet shtetit të zgjuar nacional dhe kishës në Evropë në prag të shekullit të Ri.

Por ajo që për Perëndimin ka mundur të thotë ligjësi dhe përparim në botën muslimane ka paraqitur proces jo të natyrshëm, i cili nuk ka mund të sendërtojë kurrëfarë ndërrimesh konstruktive. Laicizmi dhe nacionalizmi këtu nuk kanë pasur kurrëfarë përmbajtje pozitive dhe në të vërtetë kanë qenë vetëm negacion i diçkahit. Të huaj sipas prejardhjes dhe përmbajtjes, ata kanë qenë shprehje e plotë e mjerimit shpirtëror e cila dominante. Me ata praktikisht ka filluar akti i fundit i dramës së botës muslimane. Sipas situatës e cila është krijuar, këtë akt do të mund ta quajmë "absurd dual". Për çka është fjala?

Çdo rilindje krijohet si rezultat i kontaktit kreativ, simpatisë dhe pajtueshmërisë së brendshme ndërmjet elementeve të vetëdijshme, udhëheqëse të një shoqërie dhe shtresave të gjera të popullit. Grupa udhëheqëse është vullneti dhe mendimi, kurse populli zemra dhe giaku i çdo lëvizjeje të thellë. Pa pjesëmarrjen ose së paku pa pranimin e njeriut të rëndomtë çdo aksion mbahet në sipërfaqë dhe pa forcën e vërtetë goditëse. Ngathtësia e masave është e mundur të ngadhnjehet nëse ajo është pasojë vetëm e rezistencës natyrale kundër përpjekjes, rrezikut dhe luftës. Kjo ngathtësi është e pamundur të ngadhnjehet nëse ajo paraqet refuzim të vet idealit të luftës për shkak se ky ideal është i kundërt me vullnetin më intim dhe ndjenjat e masave.

Pikërisht këtë rastin e dytë, në formën më pak apo më shumë të shprehur, e shohim në të gjitha vendet muslimane në të cilat modernistët përpiqen t'i sendërtojnë programet e tyre. Ata lajkatojnë dhe kërcënohen, lusin dhe detyrojnë, organizojnë dhe riorganizojnë, i ndërrojnë emërtimet dhe personalitetet, por hasin në rezistencën dhe indiferenditetin e fuqishëm të njeriut të rëndomtë, të cilët e përbëjnë pjesën më të madhe të popullit. Habib Burgiba - kurse ky këtu përmendet vetëm si shembulli dhe reprezentues i një tendence të zgjeruar - mbanë rroba evropiane, në shtëpi fletë frengjisht, e izolon Tunisin jo vetëm nga bota islame, por edhe nga bota arabe, e kufizon mësimin fetar, apelon që të lëhet anash agjërimi gjatë ramazanit "sepse agjërimi e zvoglon produktivitetin e punës, edhe vetë në vend publik pi lëng portokalli që të ofrojë shembull përkatës, e pastaj pas gjithë kësaj habitet nga pasiviteti dhe mungesa e përkrahjes nga ana e masave tunisiane në reformat e tij "të ditura". Modernistët nuk do të ishin ata çfarëjanë sikur mos ta tregonin këtë lloj verbërie. Popujt muslimanë kurrë nuk do të pranojnë asgjë çka është shprehimisht kundër Islamit, sepse Islami nuk është këtu vetëm idq dhe ligj, Islami është bërë dashuri dhe ndjenjë. Kush ngritet kundër Islamit, nuk do të korrë asgjë përveç urrejtje dhe rezistencë.

Me aksionin e tyre modernistët kanë krijuar gjendjen e përleshjeve të brendshme dhe konfuzionit në të cilën bëhet i pamundshëm çdo program, barabart ai islam sikur edhe ai i buaj. Masat dëshirojnë aksion islam, por pa inteligjencën e vet nuk mund ta bartë. Inteligjencia e jetësuar e imponon programin e vet, por nuk gjenë mjaft të atillë të cilët do të jenë të gatshëm të japin giak, djersë dhe entuziazëm për atë idealin e letrës. Vie deri te dërmimi reciprok i fuqive, deri te gjendja e vflnt e pafuqisë dhe paralizës.

Ekziston një rend, një dinamik, një begati, një përparim i cili mund të ndërtohet në këtë vend dhe në këtë nënqien, por kjo s'është rend, progres dhe prosperitet i Evropës dhe Amerikës

Indiferenditeti i masave muslimane nuk është indiferenditet në përgjithësi. Kjo është mënyrë në të cilën Islami popullor është mbrojtur nga sulmet e jashtme, të huaja. Kudo që është treguar perspektiva edhe më e vogël e luftës islame, njeriu i rëndomtë ka ofruar dëshmi mbi gatishmërisë e tij që të luftojë, durojë dhe pësojë. Këtë e ka treguar shembudi i Turqisë në fazën e luftës çlirimtare kundër Grekëve pas humbjes në Luftën e parë botërore, rezistencës trimërore në Libi kundër okupatorit italian dhe shembujt e paradokohshëm të luftës kundër Anglezëve në zonën e Suezit, luftën për çlirimin e Algjerisë, për ruajtjen e Indonezisë dhe për ndikimin islam në Pakistan. Kurëdo që nevojitet të vëhen në lëvizje masat janë shfrytëzuar, qoftë edhe përkohësisht, dhe josingërisht, parollat islame. Ku ka islam nuk ka indiferenditet.

Ndjenjave të qarta të masave muslimane u nevojitet mendimi i cili do t'i vënte në lëvizje dhe do t'i orientonte. Por ky nuk mund të jetë asfarë mendimi. Ky duhet domosdo të jetë mendimi i cili i përgjigjet këtyre ndjenjave të thella. Ky, pra, mund të jetë vetëm mendimi islam.

Nuk ka kurrfarë gjasa që masat muslimane dhe udhëheqësia e tyre e sotme intelektuale dhe politike të mund të merren vesh që dikush nga ata ta refizojë idealin e tij, pa marrë parasysh në atë sa gjatë kjo gjendje e jovendosshmërisë dhe pritjes'do të mund të zgjaste. Në perspektivë shihet vetëm një dalje: krijimi dhe tubimi i inteligjencës së re e cila m'endon dhe ndien në mënyrë islame. Kjo inteligjenci me pastaj do ta ngrënte flamurin e rregullimit islam dhe së bashku me masat muslimane është nisur në aksion për sendërtimin e tij.

II. RREGULLIMI ISLAM FEJA DHE LIGJI

Rregullimi (rendi) islam - ç'do të thotë kjo fjalë e përkthyer në gjuhën me të cilën mendon, fletë dhe ndien gjenerata jonë?

Përkufizimi më i shkurtër i rregullimit islam e përkufizon si unitet të fesë dhe ligjit, edukimit dhe fuqisë, idealit dhe interesit, bashkësisë shpirtërore dhe shtetit, vullnetaritetit dhe detyrimit.

Si sintezë e këtyre komponenteve, rregullimi islam ka dy parashtrime themelore: shoqërinë islame dhe pushtetin islam. E para është përmbajtje kurse e dyta formë e rregullimit islam. Shoqëria islame pa pushtetin islam është e papërkryer dhe e dobët; pushteti islam pa shoqërinë islame është ose utopi ose dhunë.

Muslimani kryesisht nuk ekziston si vehte. Nëse dëshiron të jetojë dhe të ekzistojë si musliman, ai duhet ta krijojë mjedisin, bashkësinë, rregullimin. Ai medoemos duhet ta ndërrojë botën ose vetë do të jetë i ndërruar. Historia nuk njeh asnjë lëvizje të mirëfilltë islame e cila njëkohësisht nuk ka qenë edhe lëvizje politike. Kjo është për atë arye se Islami është fe, por njëkohësisht është edhe një filozofi, një moral, një rregullim i gjërave, një stil, një atmosferë - me një fjalë, një mënyrë integrale e jetës. Nuk mundet në mënyrë islame të besohet, kurse në mënyrë joislame të punohet, fitohet argëtohet, sundohet. Kjo gjendje e joharmonisë do të krijojë ose hipokrizi (ata në xhami e lavdojnë Zotin, jashtë e mashtrojnë), ose njerëz të pafatshëm dhe plotë konflikte (ata as që mund ta shkëpusin me Kur'anin, as që mund të gjejnë forca të luftojnë për ndërrimin e rrethanave reae në të cilat jetojnë), ose një Iloj kallogjerësh dhe vetjakësh (ata tërhiqen nga bota sepse ajo botë

nuk është islame), ose, më në fund, ata të cilët në dilemën e atillë e shkëpusin me islamin, dhe e pranojnëjetën dhe botën te ashtuj siç është, respektivisht çfarë e kanë bërë të tjerët.

Rregullimi islam është gjendje e shoqërisë pa këtë konflikt dhe sistem i raporteve në të cilat muslimani gjendet në harmoni të plotë me mjedisin e vet.

Në pyetjen: ç'është shoqëria muslimane, ne përgjigjemi: kjo është bashkësi e hartuar nga muslimanët, dhe konsiderojmë se me këtë është thënë krejtë apo pothuaj krejtë.

Domethënia e këtij përkufizimi është se nuk ekziston sistem institucionesh, marrëdhëniesh dhe ligjesh, të cilët do të mund të veçoheshn nga njerëzit të cilëtjanë subjekt i tyre dhe për të cilët do të mund të thuhej: ky është sistem islam. Asnjë sistem nuk është islam apojoislam vetëvetiu. Ai është kyvetëm sipas njerëzve të cilët e përbëjnë.

Evropiani beson se shoqëria rregullohet me ndihmen e ligjeve. Oysh nga "Shteti i Platonit", e nëpërmjet utopive të njohura mbi rregullimin ideal të shtetit, deri te më e reja nga këto utopitë, marksizmi, shpirti evropian gjurmon për një projekt, një skemë në të cilën me ndërrimin e thjeshtë të raporteve ndërmjet njerëzve ose grupeve të njerëzve, do të konstruohej shoqëria ideale.

Sandejmi në Kur'an gjenden relativisht pakë "ligje" të vërteta, kurse shumë më tepër "fe" dhe kërkesa për veprim praktik në harmoni me këtë fe.

Shumësia e ligjeve dhe ndërtikueshmëria e legjislaturës rëndom është shenjë e sigurt se në shoqëri "diç është e kalbur" dhe se duhet pushuar të sillen ligje kurse të fillohet të edukohen njerëzit. Kur çoroditja e mjedisit e kalon njëfarë kufiri, ligjet bëhen të paaftha. Ata ose vijnë në duar të

ekzekutorëve të çoroditur të drejtësisë, ose, bëhen objekt i shkeljes së hapur apo të fshehur nga mjedisi i çoroditur.

Vera, bixhozi dhe falli - tri të këqia mjaft të shtrira dhe të rrënjosura në tërë territorin e Lindjes së Mesme dhe të Afërt, janë shmangur për një periudë të gjatë dhe në teritor të madh vërtet me një të vetmin shpjegim: se këtë e ka ndaluar Zoti. Posa kjo fe u dobësua, dehja dhe supersticioni janë kthyer me fuqinë e njëjtë, kurse shkalla pakrahasueshëm më e lartë kulturore e mjedisit nuk u paraqiste kurrfarë pengese. Prohibition Law (Ligji mbi ndalimin e alkohilit) Amerikan, i shpallur në emër të shkencës së shekullit dhe i sendërtuar me fuqinë e njerës nga bashkësisë më të organizuara në botë, në dekadën e katërt u dasht përfundimisht të tërhiqet, pas përpjekjeve të kota 13 vjeçare, të përmbushura me dhunë dhe krime. Orvatja e futjes së prohibicionit në vendet Skandinave, mori fund me mossuksesin e njëjtë.

Ky dhe shumë shembuj të ngjashëm flasin qartë se shoqëria mund të përmirësohet vetëm në emër të Zotit dhe me edukimin e njeriut edhe ne duhet shkuar pas asaj rruge të vetme e cila sigurisht shpie deri në cak.

Duke e konfirmuar parimin e hyrjes shpirtërore, të brendshme në çdo manifestim të vetin, Islami megjithatë nuk ka mbetur në këtë. Ai ka bërë përpjekje që nga duart e djallit t'i grabisë mjetet e tij. Sikur Islami në relacionin njeriu - bota mos të nisej nga njeriu, ai do të ishte vetëm religion dhe do të paraqiste përsëritjen e thjeshtë të rënimit të Isusit mbi idealin dhe veprën e amshueshme të qenies njerëzore. Nëpërmjet Muhammedit a.s. dhe Kur'anit Islami i është kthyer njeriut të i, rlltë, botës së jashtme, natyrës, që të bëhet mësim për njeriun e plotë dhe jetën totale. Fcshë i është bashkuar ligji, edukatës fuqia. Islami është bërë rregullim.

ISLAMI NUK ËSHTË VETËM RELIGJION

Në këtlë pikë, e cila shënon kthesën e mirëritlltë në evoluimin e mësimëve fetare, Islami ndryshon nga të gjitha religjionet, doktrinat dhe filozofitë e jetës. Në pyetje është një pikë e re e kundërimit dhe një hyrje e veçant në të cilën pasqyrohet aspekti i filozolisë krejtësisht origjinale islame. Boshti i kësaj filozorie është kërkesa që njëkohësisht të jetohet jeta e brendshme dhe e jashtme, morale dhe shoqërore, shpirtërore dhe fizike, Ose, thënë më saktë, që vetëdijshëm dhe vullnetarisht të pranohen këto dy aspekte të jetës si përcaktim i njeriut në tokë (Kur'ani 28,77). Duke e përkthyer këtë kërkesë në gjuhën e jetës së përditshme, do të mund të themi: ai kush beson se jetën duhet rregulluar jo vetëm me fe dhe lutje, por edhe me punë dhe shkencë; fotografia e botës e të cilitjo vetëm që lejon, por edhe kërkon, që njëra pranë tjetrës të qëndrojnë edhe faltarja edhe fabrika; kush konsideron se duhet jo vetëm edukuar njerëzit, por edhe të lehtësohet dhe përparohet jeta e tyre në tokë, dhe se nuk ekzistojnë kurrfarë shkaqesh që këto dy caqe të flijohen njëri pas tjetrit, - ky i përket Islamit.

Përveç besimit në Zotin në këtë është përmbajtur porosia kryesore e Kur'anit dhe në të është tërë Islami. Çdo gjë tjetër është vetëm përpunimi dhe shpjegimi i tij. Ky aspekt i Islamit, përveç asaj që e përmbanë vetë parimin e rregullimit islam, si unitet të fesë dhe politikës, shpie edhe deri te përfundimet tiera të rëndësishme, rëndësia parimore dhe praktike e të cilëve është shumë e madhe.

Përfundimi i parë dhe më i rëndësishëm i këtillë është përfundimi mbi papajtueshmërinë e Islamit dhe sistemeve joislame. Nuk ka paqë as koekzistencë ndërmjet "fesë islame" dhe institucioneve joislame shoqërore dhe politike. Mosfunksionimi i këtyre dy institucioneve dhe jostabiliteti i

regjimit në vendet muslimane, i cili shprehet në ndërrimet e shpeshta dhe grushtshtetet shtetërore, më së shpeshti është pasoja e opozicionit të tyre a prior kundruall Islamit, si ndjnjën fundamentale dhe udhëheqëse të popullit në këto vende. Duke marre për të drejtë që vetë ta rregullojë botën e vet, Islami qartë e përjashton të drejtën dhe mundësinë e veprimit të cilës do ideologji të huaj në territorin e tij. Nuk ka, pra, parim laik, kurse shteti duhet të jetë shprehje dhe t'i përmbajë konceptet morale të religjionit.

Ky është përfundimi i parë dhe, më i rëndësishmi nga hyrja e Islamit si rregullim integral. Tri përfundimet tjera po ashtu të rëndësishme - por më pak përjashtuese - janë:

I pari - me vetë atë që është përcaktuar për këtë botë, Islami është përcaktuar për botën më mirë të rregulluar. Asgjë çka bënë që bota të jetë më e mirë, nuk mund të refuzohet apriori si joislame.

I dyti - çiltëria ndaj natyrës do të thotë çiltëria ndaj shkencës. Çdo zgjidhje që të jetë islame duhet pa tjetër t'i plotësojë dy kushte: duhet të jetë maksimalisht efikasq dhe maksimalisht humane. Ajo duhet, pra, të jetë shprehje më e lartë e qëndrimeve të barmonizuara të fesë dhe shkencës, dhe

I treti - duke treguar në një formë të lidhshmërisë ndërmjet fesë dhe shkencës, moralit dhe politikës, individuale dhe kolektivës, shpirtërores dhe materiales, në të cilat pyetje shpirtërisht është ndarë bota e sotme, Islami sërish fiton rolin e mendimit ndërmjetësues kurse bota muslimane rolin e kombit ndërmjetësues në botën e ndarë. Duke e paraqitur premtimin e "religjionit pa mistikë dhe shkencës pa ateizëm", Islanii barabartë mund t'i bëjë të interesuar të gjithë njerëzit pa dallim.

RREGULLIMI ISLAM I KOHËS SONË - TEZAT

Ekzistojnë parimet e pandryshueshme islame të cilët i përcaktojnë raportet ndërmjet njeriut dhe njeriut dhe bashkësisë, por nuk ekziston kurrfarë sistemi i pandryshueshëm islam ekonomik, shoqëror ose politik, i cih do tëjipej qysh më parë për të gjitha kohët. Burimet islame nuk e përmbajnë përshkrimin e sistemit të atillë. Mënyra në të cilën muslimanët do të zhvillojnë aktivitetin ekonomik, do ta organizojnë shoqërinë dhe do të sundojnë në ardhmëri, do të ndrysojnë, pra, nga mënyra në të cilën ata kanë zhvilluar aktivitet ekonomik, e kanë organizuar shoqërinë dhe kanë sunduar në të kaluarën. Para çdo kobe dhe para çdo gjencrate qëndron detyra të gjejë forma dhe mjete të reja që porositë themelore të Islamit, të cilat janë të amshueshme dhe të pandryshueshme t'i sendërtojë në një botë, e cila nuk është e amshueshme dhe e cila i është e nënshtuar ndërrunit të përhershëm.

Edhe gjenerata jonë pa tjetër duhet ta pranojë rrezikun dhe ta bëjë këtë përpjekje.

Të vetëdijshëm për papërkryershmërinë gjithnjë, më të pashmangshme të përkufizimeve të këtij lloji dhe duke u kufizuar në parimet për të citat na duket se në këtë çast kanë rëndësi më të madhe, ne po i ekspoizojmë me këtë radhë:

(NJERIU DHE BASHKËSIA)

Shoqëria islame është bashkësi e organizuar e besimtarëve. Nuk ka shpëtim të pastër shkencor, revolucionar, socialiste ose çfarëdo shpëtimi tjetër, ekskluzivisht të jashtëm për njeriun dhe shoqërinë. Shpëtimi i cili nuk do të thotë edhe kthim i brendshëm, ndërrimin e njeriut, përtëritjen e tij të brendshme - kurse këso nuk ka pa Zot - është i rrejshëm.

Shoqëria islame nuk mund të themelohet vetëm në interesin social ose ekonomik, ose në cilin do faktor tjetër të jashtëm, teknik të lidhshmërisë. Si bashkësi e besimtarëve, ajo në bazën e saj përmbanë një moment religion emocional të përkatësisë. Ky element më së qarti është i dukshëm dhe është i përfshirë në xhemaat, si njësisë themelore të shoqërisë islame.

Për dallim nga shoqëria e cila është bashkësi abstrakte me raportet e jashtme të anëtarëve, xhemaati është bashkësi e brendshme, konkrete, e cila themelohet në përkatësinë shpirtërore dhe ku lidhja ndërmjet njerëzve mbahet me të kontaktuarit e drejtpërdrejtë, personal dhe me të njohurit. Në të gjendet njeriu kundruall njeriut, e jo anëtari anonim i shoqërisë kundruall anëtarit po të atillë të shoqërisë. Si faktor i njoftimit dhe afrimit të njerëzve, xhemaati i kontribuon solidaritetit dhe harmonisë së brendshme të shoqërisë dhe i ndihmon dëbimit të shpirtit të vetmisë dhe tjetërsimit, të cilin na sjell teknika dhe urbanizimi në rritje.

Përveç kësaj, xhemaati i këtyllë krijon një lloj të mendimit publik i cili vepron pa dhunë, por megjithatë në mënyrë mjaft efikase, kundër kundërvajtësve potencial të turmave shoqërore dhe morale. Në xhemaat askush s'është vetëm dhe atë në kuptim të dyfishtë: nuk është vetëm që të mund të punojë ç'të dojë, as është vetëm, i lënë vetëvetes, që t'i mungojë përkrahja morale dhe

materiale. Nëse muslimani nuk ndien praninë e të tjerëve, shoqëria muslimane s'është e suksesshme.

Islami dëshiron që njeriu njeriut drejtpërdrejt t'ia shtrijë dorën. Asgjë në kuptim - të vërtetë nuk është bërë deri sa kjo nuk arrihet. Islami nuk pranon që gjendja të përjetësohet në të cilën shteti do të detyrohet që me forcë të ndërmjetësojë dhe t'i mbrojë njerëzit nga njëri tjetri. Këtë gjendje Islami mund ta pranojë vetëm kushtimisht dhe përkohësisht. Forca dhe ligji janë vetëm mjete të drejtësisë. Vetë drejtësia gjendet në zemrat e njerëzve, ose, ajo nuk ekziston.

(BARABARËSIA E NJERËZVE)

Dy fakte të rëndësishme magjistrale - uniteti i Zotit dhe barabarësia e të gjithë njerëzve - janë të konfirmuara me Kur'an në mënyrën aq të qartë dhe shprehimore, që lejojnë vetëm një të vetmin komentim tekstual: nuk ka hyjni përveç një Zoti; nuk ka popull të zgjedhur, racë të zgjedhur ose klasë të zgjedhur - të gjithë njerëzit janë të barabartë.

Islami nuk mund ta pranojë ndarjen ose grupimin e njerëzve sipas kriterit të jashtëm, objektiv çfarë është ai klasor. Për të si lëvizje fetaro-morale është e papranueshme çdo dallim i njerëzve i cili nuk i inkuadron kriteret morale. Njerëzit duhet pa tjetër të dallohen - nëse tashmë dallohen - para së gjithash sipas asaj që ata vërtet janë, çka do të thotë sipas vlerës së tyre shpirtërore dhe etike (Kur'ani, 49,13). Të gjithë njerëzit korrekt, pa marrë parasysh se si gjatë ditës e fitojnë bukën e tyre, i përkasin bashkësisë së tyre, sikur që horrët dhe të çoroditurit e të gjitha llojeve, i përkasin

"klasës" së njëjtë, pa marrë parasysh në përcaktimin e tyre politik dhe vendin në procesin e punës. Ndarja klasore është barabartë e padrejtë, morale dhe njerëzishme e papranueshme, sikur edhe ndarja nacionale dhe të ndryshme dhe dallimi i njerëzve.

(VËLLAZËRIMI I MUSLIMANËVE)

"Muslimanët janë vëllezër" (Kur'ani, 49,10). Me këtë porosi Kur'ani e ka shënuar synimin, i cili për shkak të largësisë së tij mund të jetë burim i frymëzimit për të lëvizurit e përhershëm përpara. Ndryshimet e mëdha tek njerëzit dhe jashtë tyre dubet të sendërtohen, që të zvogëlohet largësia në rrugën derite vëllazërimi i proklamuar.

Në këtë parim ne shohim autorizimin dhe obligimin për bashkësinë islame që të themelojë institucione përkatëse dhe të aplikojë masa konkrete që marrëdhëniet ndërmjet muslimaneve në jetën e njëmendët të kenë gjithnjë e më shumë elemente dhe karakteristika të vëllazërimit. Numri dhe lloji i masave, iniciativave dhe ligjeve, të cilat pushteti i mirëfilltë islam do të mund t'i nxirrte duke u thirrur në parimin e vëllazërimit të të gjithë muslimanëve, praktikisht është i pakufizuar.

T'i përmendim këtu ndryshimet e mëdha pasurore dhe shoqërore dhe feudalizmin si rastin më drastik. Raporti ndërmjet bujkrobit dhe feudalitit nuk është raport vëllazërimi, por raport i nënshtrueshmërisë dhe varshmërisë dhe, si i tillë, është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me Kur'anin dhe këtë parim.

(UNITETI I MUSLIMANËVE)

Islami përmbanë parimin e ummetit, dmth. synimin për bashkimin e të gjithë muslimanëve në bashkësi unike - fetare, kulturore dhe politike. Islami nuk është nacionalitet, por është mbinacionalitet i kësaj bashkësie.

Çdo gjë që i ndanë njerëzit në këtë bashkësi, qoftë ka të bëjë me gjerat ideore (sektet, madhhebet, partitë politike e tjera), ose materiale (ndryshimet e mëdha pasurore, rangjet shoqërore e të ngjashme), është e kundërt me këtë parim të unitetit dhe si e tillë duhet pa tjetër të jetë e kufizuar dhe e shmangur.

Islami është pika e parë, kurse panislamizmi pika e dytë, me të cilën përkufizohet linja kultitare ndërmjet tendencave islame dhe joislame në botën e sotme muslimane. Një bashkësi është po aq islame, sa më tepër Islami i përcakton raportet e saj të brendshme, kurse panislamizmi raportet e saj të jashtme. Islami është ideologjia e saj, kurse panislamizmi politika e saj.

(PRONËSIA)

Edhe pse Islami e pranon pronësinë private, shoqëria e re islame do të nevojitet qartë të deklarojë se të gjitha burimet e mëdha të pasurisë shoqërore, e sidomos burimet natyrore, do të duhet pa tjetër të jenë në pronësi të bashkësisë dhe do t'ju shërbej të mirave të të gjithë anëtarëve të saj. Mbikqyrja shoqërore mbi burimet e pasurisë është e domosdoshme që, nga një anë, të pengojë

pasurimin e pabazë dhe fuqinë e individëve, kurse nga ana tjetër, që të sigurohet baza materiale për sendërtimin e programit të zhvillimit në sferat e ndryshme të jetës, të cilat do t'i ndërmerren bashkësisë në pajtim me rolin gjithnjë e më të madh të shoqërisë së organizuar në jetën e popujve. Ndonëse ndryshëm është shtruar dhe zbatuar, pjesëmarrja e shoqërisë në zgjidhjen e numrit gjithnjë e më të madh të punëve të përbashkëta, është barabartë e madhe në SHBA, Bashki min Sovjetik ose në Suedi, çka tregon se nuk ka të bëjë me pyetjen e hyrjes ideore ose politike, por me domosdoshmërinë, e cila buron nga kushtet e jetës të bashkësive njerëzore në kohën bashkëkohore.

Pronësia private i është nënshtruar edhe një herë kufizimit në bazë të urdhërit shprehimor të Kur'anit - përdorimit të saj të detyrueshëm për qëllime të përgjithshme të dobishme (Kur'ani, 49,34). Në Islam, pra, nuk ka pronësi private në kuptim të koncepteve të të drejtës romake. Në krahasim me atë romake, pronësia private e sheriatit ka një autorizim më pak (iusabutendi - e drejta e përdorimit) dhe një obligim më tepër (obligimin e përdorimit për të mirën e përgjithshme). Për pushtetin e mirëfilltë islam, pasojat praktike të këtij dallimi janë largpamëse. Në bazë të saj dhe urdhërit të cituar të Kur'anit, legale janë të gjitha masat ligjore dhe praktike kundër formave të ndryshme të mospërdorimit dhe keqpërdorimit të pronës private. Eliminimi i padrejtësisë, jobarabarësisë e sidomos luksit dhe shkapërderdhjes gjatë kohës së mjerimit, si fenomene të cilat e shkatërrojnë bashkësinë dhe i ndajnë njerëzit, do të shtrohet në një çast para rregullimit islam si pyetje e të ekzistuarit të tij dhe siguri provues i vlerës së mirëfilltë të qëndrimeve etike dhe shoqërore të cilat ai i paraqet.

(ZEKATI DHE KAMATA)

Ndër dispozitat Islame të cilat kanë peshë të shprehur sociale, vend të veçant zë një urdhëresë dhe një ndalesë: urdhëresa e zekatit dhe ndalesa e kamatës.

Në zekat ne shohim parimin e konfirmuar të përgjegjësisë reciproke dhe kujdesit të njerëzve për latin e nieri tjetrit. Ky parim, njëherë i proklamuar, mund të bëhet bazë për forma të reja të ndryshme të kujdesit në pajtim me zhvillimin, nevojat dhe mundësitë e shoqërisë.

Në botën e sotme muslimane zekati është çështje private e çdo individi dhe në gjendjen ekzistuese të vetëdijes shoqërore dhe fetare, ai është plotësisht jashtë funksionit. Mosprania e zekatit është e dukshme në çdo hap. Zekati është institucion publiko-juridik i rregullimit islam, funksionimi i të cilit duhet medoemos të sigurohet në çdo mënyrë, duke e inkuadruar përdorimin e fuqisë.

Me ndalimin e kamatës (Kur'ani, 11, 275-279) është vendosur norma e përhershme e rregullimit publik të shoqërisë islame, e cila do të thotë ndalesën dhe heqjen jashtë ligjit çdo lloj të rentës dhe të gjitha format e të fituarit parazitator, dtth. të përvetësuarit e të mirave në bazë të të poseduarit të thatë, si fenomen i kundërt me botëkuptimet morale dhe me bazat në të cilat mbështetet rregullimi publik islam.

(PARIMI REPUBLIKAN)

Përveç në gjerat pasurore, Islami nuk njih kurrfarë parimi të trashëgimisë, as çfarëdo pushteti me prerogativa absolute. Pranimi i pushtetit absolut All-Ilahut, do të thotë mospranimi absolut i çfarëdo pushteti tjetër të gjithmundshëm. (Kur'ani, 7,3; 12,40). "Nuk është i lejueshëm kurrfarë nënshtrimi krijesës, i cili inkuadron mosnënshtrim Krijuesit" (Muhammedi a.s.). Në historinë e rregullimit të parë autentik islam e mbase deri tash edhe të fundit - perioda e katër halifëve të parë, ne qartë shohim tri aspekte thelbësore të parimit republikan të pushtetit: 1) Rizgiedhja e sherit të shtetit; 2) Përgjegjësia e sherit të shtetit para popullit; 3) Obligimin e zgjedhjes së përbashkët të punëve të përgjithshme dhe shoqërore. Këtë të fundit shprehimisht e urdhëron edhe Kur'ani (3,159;42,38). Katër sunduesit e parë në historinë islame nuk kanë qenë kurrëfarë mbretër. Ata kanë qenë të zgjedhur nga ana e popullit. Halifati trashëgues paraqet lëshimin e principit të zgjedhjes i cili është atirmuar si institucion i qartë politik islam.

(NUK KA HYJNI TJERA PERVEÇ ALL-LLAHUT)

Në përmasën në të cilën konsiderojmë se sendërtimi i rregullimit islam është synim i pacenueshëm, i cili nuk mund të jetë objekt i kurrfarë mbivotimi, aq më qartë e refuzojnë pacenueshmërinë e personalitetit, pa marrë parasysh në meritat e tij dhe pozitën të cilën e zë. Në këtë kuptim, rregullimi islam është sintezë e autoritetit absolut (në krahasim me programin) dhe demokracinë absolute (në krahasim me personalitetin).

Në Islam nuk ka të gjithmençur, të gjithdijshëm, të pagabueshëm dhe të pavdekshëm. Vetëm Muhammedi ka qenë i gabueshëm dhe si i tillë është qortuar (Kur'ani, 80,1-12). Në këtë pikëpamje, Kur'ani është liber realist, pothuaj antiheroik. Fenomeni i lavdimit të personalitetit, mjaft i shpeshtë në Lindje sikur edhe në Perëndim, sot sikur edhe në të kaluarën, shprehimisht është i huaj për Islamin edhe për atë sepse paraqet një lloj idhujtarie (Kur'ani, 9,31). Kriter i vlerës së vërtetë të çdo njeriu është jeta e tij personale dhe raportet ndërmjet asaj çka ijep bashkësisë dhe çka nga ajo merrë. Tërë lavdia dhe falënderimi i përket vetëm Zotit, kurse meritat e vërteta të njerëzve vetëm Zoti mund t'i vlerësojë.

(EDUKATA)

Pasi që feja është bazë e shoqërisë islame, edukata nuk është vetëm një funksion i saj, por gjendja e ekzistencës së saj. Kjo para së gjithash është edukatë fetare dhe morale në familje, e pastaj nëpër të gjitha shkallët e shkollës. Detyrë e veçant e rregullimit islam është lufta erikase për eliminimin e të gjitha formave të antiedukimit. Islami e ka ndaluar, kurse rregullimi islam me masa konkrete do t'i pamundësojë:

- të gjitha format e alkoholizimit të popujve,
- prostitucionin publik dhe të fshehtë,
- pornografinë në rjalë, fotografali, film dhe TV,

- kumarhanet, klubet e natës dhe dansing klubet dhe format tjera të argëtimit, të cilat janë në mospajtim me botëkuptimin moral të Islamit.

(ARSIMI)

Pjesa përbërëse e kësaj edukate integrale është shkollimi i brezit të ri, krijimi i shprehisë së punës dhe stërvitja. Krahas unitetit, arsimi është faktori i dytë vendimtar i emancipimit të shpejtë të botës muslimane nga pozita e tashme inferiore. Vendet muslimane nuk kanë kapital të mjaftueshëm, e kur kjo është kështu, atëherë atë që e kanë duhet ta deponojnë në investicion i cili është më rentabil nga të gjithë të tjerët: në arsim.

Nuk ka mëvetshmëri të mirëfilltë pa aftësi që vetë t'i aplikojmë dhe t'i përdorim të arriturat e shkencës dhe që këto të arritura më tej t'i përparojmë. Në daljen e tij të parë në skenë Islami pa paragjykimet e ka hyrë shqyrtimit dhe tubimit të tërë diturisë të cilën e kanë lënë qytetërimet e mëhershme. Nuk dimë pse Islami i sodit ndryshe do të sillë ndaj të arriturave të qytetërimet evrop-amerikan me të cilën prekej në vijën aq të gjatë.

Nuk është, pra, pyetja në atë se a do ta pranojmë apo jo shkencën dhe teknikën - sepse do të detyrohemi t'i pranojmë nëse duam të ekzistojmë - por a do ta bëjmë këtë kreativisht apo mekanikisht, me dinjitet apo me inferioritet. Pyetja, pra, është se a do të humbemi në këtë zhvillim të pashmangshëm, ose do ta ruajmë individualitetin tonë, kulturën tonë dhe vlerat tona.

Duke i pasur parasysh këto fakte, me siguri të plotë mundemi të dëklojrmë se sistemi shkollor në botën e sotme muslimane është institucion i cili kërkon ndryshimet më urgjente dhe më radikale kualitative dhe kuantitative. Kualitative - që sistemi shkollor të lirohet nga varshmëria shpirtërore, e në disa raste edhe materiale nga të huajt dhe të fillojë t'i shërbejë edukimit të muslimanëve si njerëz dhe si anëtarë të bashkësisë islame. Kuantitative - që të shmanget jomjaftueshmëria kronike në këtë pikëpamje dhe në afatin më të shkurtër të krijohen kushtet që me shkollim dhe mësim të përfshihen tërë rinia dhe të gjitha shtresat e popullit. Në stadiion fillestare, xhamia mund të përdoret sërish si shkollë. Nëse në programet e arsimit nuk përjetojmë humbje, nuk ekziston fushë në të cilën do të mund të jemi të ngadhnjyer.

(LIRIA E NDËRGJEGJES)

Edukimi i popullit, e sidomos mjetet e ndikimit masovik shtypi, radioja, televizioni dhe filmi - duhet të jenë në duart e njerëzve, autoriteti islam moral intelektual i të cilëve është i padiskutueshëm. Nuk duhet lejuar që këto njëte - që pothuaj është rregull t'i shtijnë në dorë njerëzit e përdhosur dhe të degjeneruar, që nëpërmjet tyre, absurditetin dhe zbratësinë e jetës vetjake ta përcjellin te të tjerët. Ç'mund të presim nëse nga xhamia dhe pyrgu i televizionit Popullit i vijnë porosi krejtësisht të kundërta? Mirëpo, kjo kurrsesi nuk do të thotë që nga rregullimi islam mund të krijohet gjendja e diktaturës shpirtërore, në të cilën të vërtetën do ta proklamojë pushteti dhe ku do të ngritet uniformizëm dhe rini pa individualitet. Kjo vetëm do të thotë se ekzistojnë disa qëndrime clementare dhe disa rregulla themelore të mirësjelljes, të cilat në

të gjitha rastet do të duhen pa tjetër të respektohen. Në Islam, duke marrë parasysh parimin e proklamuar mbi lirinë e fesë (Kur'ani, 2,266), çdo detyrim, fizik dhe psikologjik, në pyetjet e ndërgjegjjes dhe përcaktimit shprehimisht është i palejueshëm, e duke marrë parasysh parimin e ixhmasë-konzensusit, edhe i panevoishëm ("Populli im nuk mund të pajtohet në lajthim" Muhammedi a.s.). Sado qoftë që moralisht është puritan, Islami për shkak të çiltërisë së tij natyrës dhe hareve, është liberal, dhe për këtë dëshmon tërë historia islame. Pasi e pranon Zotin, por nuk pranon kurrfarë dogmash dhe hierarkie, Islami nuk mund të shndërrohet në diktaturë dhe çdo formë inkuizicioni dhe terrori shpirtëror është pamundësuar.

(ISLAMI DHE PAVARËSIA)

Nuk ka rregullim Islam pa pavarësi dhe liri. Dhe anasjelltas: nuk ka pavarësi dhe liri pa Islam. Ky qëndrim i fundit ka domethënie të dyfishtë.

E para, pavarësia është e mirëfilltë dhe e përhershme nëse është rezultat i pavarësisë së fituar shpirtërore, ideore, nëse pra, është shenjë se një popull e ka gjetur vetëveten, i ka zbuluar fuqitë e brendshme të saja, pa të cilat pavarësinë e arritur nuk mund ta përmbushë me përmbajtje, as ta ruaj gjatë kohë. Në afirmimin e mendimit islam në jetën praktike, çdo popull musliman e përjeton këtë njëjtësim me vetëveten, lirinë shpirtërore të tij, si kusht të liritë shoqërore dhe politik.

E dyta, përkrahja e vërtetë të cilën një popull musliman ia ofron regjimit në pushtet, është në proporcione të drejtpërdrejta me karakterin islam të pushtetit. Ajo është, pra, gjithnjë e më e vogël sa që regjimi në fjalë është më larg nga Islami. Regjimet joislame mbeten pothuaj plotësisht të privuara nga kjo përkrahje dhe aq më tepër duhet pa tjetër- duan apo nuk duan - të kërkojnë mbështetje të huaja. Varshmëria në të cilën bijnë ata tregohet si pasojë e drejtpërdrejtë e orientimit të tyre joislam.

Me këto fakte është përcaktuar edhe karakteri i rregullimit islam si demokraci, jo demokraci si formë, por demokraci si esencë, si koncensus. Ky lloj i demokracisë ekziston atje ku pushteti e shndërron në mendim dhe aksion atë çka populli e ndien, ku ajo vepron si shprehje e drejtpërdrejtë e këtij vullneti. Vendosja e rregullimit islam tregohet si akt kulminativ i demokracisë, sepse do të thotë sendërtim i synimeve më të thella të popujve muslimanë dhe njeriut të rëndomtë. Një është e sigurt: pa marrë parasysh ç'dëshiron një pjesë e pasanikëve dhe inteligjencës, njeriu i rëndomtë e dëshiron Islamin dhe jetën në bashkësinë e vet islame. Demokracia këtu nuk rrjedh nga parimet dhe proklamacionet, por nga faktet. Rregullimi Islam% nuk zbaton dhunë thjeshtë për shkak se nuk ka nevojë për të. Anasjelltas, rregullimi joislam, duke ndier rezistencë të përhershme dhe armiqësi të popujve, gjcë daljen e vetme në aplikimin e dhunës. Shndërrimi i tui në diktaturë është një lloj ligjshmërie, fat të cilit ai nuk mund t'i shmagnet.

(PUNA DHE LUFTA)

Shoqëria islame duhet ta merrë mbi vete detyrën e mobilizimit të burimeve njerëzore dhe natyrale dhe me masat e veta ta nxisë punën dhe aktivitetin. Të ekzistuarit, fuqia ose dobësia e shoqërisë islame i është e nënshtruar ligjeve të njëjta të punës dhe luftës sikur edhe bashkësitë tjera dhe në këtë pikëpamje shoqëria jonë nuk gëzon te Zoti kurrfarë privilegjesh. (Kur'ani, 5, 57).

Nga psikologjia e mendimit tonë publik duhet eliminuar dy gjera: besimin në çudira dhe pritjen e ndihmës së huaj.

Çudirat nuk ekzistojnë, përveç atyre që i krijojnë njerëzit me punë dhe dije. Nuk ka kurrfarë Mehdiu i cili në mënyrë të çuditshme do t'i largojë armiqët, do ta shmangë mjerimin dhe do ta mbjellë arsimin dhe mirëqenien. Mehdiu është emër për përtacinë tonë, ose edhe më tepër për shpresën e rrejshme, e cila rritet nga ndjenja e paaftësisë sonë në situatën kur madhësia e vështirësisë dhe problemit është në disharmoni të plotë me mundësitë dhe mjetet e luftës.

Mbështetja në ndihmën e huaj është forma e dytë e supersticionit. Na është bërë shprehje që ndër disa vende joislame të kërkojmë dhe të gjejmë ose miqtë e vërtetë ose armiqtë e përbetuar, dhe këtë e kemi quajtur politikë tonën të brendshme. Kur të kuptojmë se me të vërtetë nuk ka as miqë të vërtetë as armiqtë të vërtetë dhe kur për vështirësitë tona më tepër ta fajësojmë veten, e më pak "planet djallëzore të armikut", kjo do të jetë shënja se ka filluar pjekuria jonë dhe se vjen epoka më me pak vështirësi dhe dëshprim. Përndryshe, madje edhe sikur të kishte asosh të cilët do të jenë të gatshëm të ofrojnë ndihmë pa kundërshtime të panumërta politike dhe materiale, kjo nuk do të mundte qenësisht ta ndërrojë pozitën tonë. Sepse, pasuria nuk mund të sillet në një

vend. Ajo duhet të krijohet në vetë atë në bazë të punës vetjake. Atë që dëshirojmë ta arrijmë, duhet pa tjetër ta bëjmë vetë. Këtë askush as nuk dëshiron as nuk mund ta bëjë në vend se ta bëjmë ne.

Ky program i punës dhe i aktivitetit ka mbështetje e cila mund të jetë burim i trimërimit të jashtëzakonshëm. Pasuritë umslimane natyrore dhe mundësitë e botës janë shumë të mëdha. Vetëm një pjesë e asaj bote - Indonezia, paraqet pas SHBA-së dhe BRSS-së territorin kompakt të tretë më të pasur sipas radhës në botë. Bota Islame e marrë si tërësi, në këtë pikëpamje qëndron në vendin e parë.

Duke e paralajmëruar rilindjen, ne nuk e paralajmërojmë epokën e sigurisë dhe qetësisë, por epokën e joqetësisë dhe sprovave. Ka tepër shumë giera të cilat lusin për rrënuesit e tyre. Për këtë arsye këto nuk do të jenë ditë të mirëqenies, por ditë të dinjitetit. Populli i cili flenë mund të zgjohet vetëm me goditje. Kush i dëshiron mirë bashkësisë sonë, nuk, duhet ta kursejë nga orvatjet, rreziqet dhe skamjet. Përkundrazi, ai duhet bërë çmos që ajo bashkësi sa më parë t'i përdorë fuqitë e veta, t'i vejë në provë të gjitha mundësitë e tij, ta marrë rrezikun, me një fjalë - të mos fle, por tëjetojë. Vetëm i zgjuar dhe aktiv, ai mund ta gjejë vetën dhe rrugën e tij.

(GRUAJA DHE FAMILJA)

Pozita e gruas në shoqërinë muslimane duhet gjithkund të ndërrohet në harmoni me detyrën e saj të nënës dhe edukatorin natyral të brezit të ri. Nëna e paarsimuar, e lënë pas dore dhe e

pafatshme nuk mund t'i ngrisë'dhe edukojë bijtë dhe bijat, të cilët janë të aftë të nisin dheime sukses ta udhëheqin rilindjen e PoPuive muslimanë. Islami duhet nisur iniciativën që nënës t'i njihet rangu i funksionit shoqëror. Haremet do të abrogohen. Askush nuk ka të drejtë që të thirret në Islam që ta mbajë padretësinë ndaj femrës dhe keqpërdorimit të këtij lloji duhet t'i jepet fund.

Këto qëndrime nuk janë kurrfarë feminizmi i natyrës perëndimore, i cili e ka shprehur synimin që shoqërisë t'i imponohen kriteret, teket dhe sundimi i shtresës së çoroditur të gjinisë femrore. Kjo nuk është as barabarësi në kuptimin evropian. Kjo është theksimi i vlerës së njëjtë të mashkullit dhe të femrës, së bashku me theksimin e dallueshmërisë së tyre e cila duhet të jetë e ruajtur. Kurse parimi i vlerës së njëjtë është pasojë e drejtpërdrejtë e rregullave të obligimeve të njëjta fetare dhe morale, e cila në disa vende në mënyrë të shprehur është ekspozuar në Kur'an (vcçmas ajeti 33,55).

Qytetërimi nga femra ka bërë objekt i cili shfrytëzohet ose të cilit i robërohet, por femrës ia ka marrë personalitetin, e cila e vetmeja mund të jetë bartës i vlerave dhe respektit. Duke e mospërfillur detyrën e nënës, ai gruan e ka privuar nga funksioni i saj themelor dhe i pazëvendësueshëm.

Në këtë epokë kur familja po kalon nëpër krizë serioze dhe kur vlera e saj është vënë në pikëpyetje, Islami sërish e konfirmon lojalitetin e saj kësaj forme të jetës njerëzore. Duke i kontribuar sigurisë së stroullës familjare dhe duke i larguar faktorët e jashtëm dhe të brendshëm të cilët e rrënojnë (alkoholi, amorali, mospërgjegjësia), Islami praktikisht e mbronë interesin më të

lartë të vërtetë të femrës së shëndoshë dhe normale. Në vend të barabarësisë abstrakte, ai femrës i siguron dashuri, kurorëzim dhe fëmijë, me tërë atë çka për femrën do të thonë këto tri gjera.

E drejta familjare dhe martesore e cila është formuar në shekujt e parë të Islamit, do të jctë e nevojshme të rishqyrtohet në pajtim me nevojat e sotme dhe me shkallën e zhvillimit të vetëdijes njerëzore dhe shoqërore, me tendencën që të shkohet në të ngushtuarit sa më të madh të poligamisë dhe në drejtim të eliminimit të saj të shkallërishtëm nga jeta praktike, sikur edhe në kuptim të kufizimit të shkurorëzimeve dhe mbrojtjes efikase materiale të femrës dhe fëmijëve në këto raste.

(CAKU NUK ARSYETON MJETIN)

Në luftë për rregullimin islam është i lejuar përdorimi i të gjitha mjeteve, të gjithave përveç njerit, përveç krimin. Askush nuk ka të drejtë emrin e bukur të Islamit dhe këto luftëra t'i njollosë me aplikimin e pakontrolluar dhe të tepërt të dhunës. Bashkësia islame duhet edhe njëherë të konfirmojë se drejtësia paraqet një nga themelet e tij. Kur'ani nuk ka urdhëruar t'i duam armiqët, por shprehimisht na ka urdhëruar të jemi të drejtë dhe të falim (Kur'ani, 4,15 dhe 16, 126). Përdorimi i fuqisë duhet patjetër të jetë në harmoni me këtë parim.

Formula: caku arsyeton mjetin, është bërë shkak i krimeve

të panumërta. Caku i lartësuar nuk mund ta shenjtërojë mjetin jo të denjë, por për këtë shkak përdorimi i mjetit jo të denjë mund ta zvogëlojë dhe komprometojë çdo cak. Sa më të fortë të jemi moralisât, aq më pak do të na nevojitet fuqia, e cila në pyetjet e përcaktimit është armë e të ligëve, e jo e të fortëve. Atë që nuk mundet fuqia, mundet bujaria, përpikshmëria, qëndrimi i guximshëm (Kur'ani, 16,125; 26, 34-35).

(PAKICAT)

Rregullimi islam mund të sendërtohet vetëm në vendet në të cilat muslimanët paraqesin shumicën e banorëve. Pa këtë shumicë, rregullimi islam reduktohet vetëm në pushtet (sepse mungon elementi i dytë - shoqëria islame) dhe mund të shndërrohet në dhunë.

Pakicat jomuslimane në përbërje të shtetit islam, me kusht të lojalitetit, gëzojnë liri fetare dhe tërë mbrojtjen.

Pakicat muslimane në përbërje të bashkësive joislame, me kusht të garancive të lirive fetare dhe jetës normale dhe zhvillimit, janë lojale dhe janë të obligueshme t'i zbatojnë të gjitha detyrat ndaj asaj bashkësie, përveç atyre të cilat i bëjnë dëm Islamit dhe muslimanëve.

Pozita e pakicave muslimane në bashkësitë joislame gjithnjë realisht do të giendet në varshmëri nga fuqia dhe autoriteti i bashkësisë botërore islame.

(MARËDHËNIET NDAJ BASHKËSIVE TJERA)

Marrëdhëniet e bashkësisë islame ndaj bashkësive tjera në botë mbështeten në parimet:

1. Lirisë së përcaktimit fetar (Kur'ani, 2,156);
2. Fuqisë dhe mbrojtjes energjike dhe aktive (Kur'ani, 8, 61-62; 42, 39-42; 2, 190-192;);
3. Ndalesës së luftës ofanzive dhe krimit (Kur'ani, 2, 190-192; 42,42),
4. Bashkëpunimit dhe njoftimit reciprok të popullit ndërmjet veti (Kur'ani, 49,13);
5. Respektimit të obligimeve - kontratave të marra (Kur'ani, 9,4) dhe;
6. Dyanshmërisë - reciprocitetit (Kur'ani, 9,8).

PROBLEMET E RREGULLIMIT ISLAM SOT RILINDJA ISLAME- REVOLUCION FETAR APO POLITIK?

Rregullimi islam është unitet i fesë dhe sistemit shoqëroro-politik. A mos rruga deri tek ai shpie nëpërmjet rimëkëmbjes fetare apo revolucionit politik?

Përgjigja në këtë pyetje është: rilindja islame nuk mund të fillojë pa revolucion fetar, por nuk mund të vazhdohet dhe përfundohet me sukses pa revolucion politik.

Kjo përgjigje, e cila rilindjen islame e përkufizon si revolucion të dyfishtë - moral dhe shoqëror, por i cili përparësi qartë i jep rimëkëmbjes fetare, rrjedh nga parimi dhe natyra e islamit, por edhe nga disa fakte të zymta, me të cilat është karakterizuar realiteti i botës së sotme muslimane.

Këto fakte flasin mbi gjendjen e rëndë morale në botën muslimane, mbi çoroditjen e karakterit, dominimin e korrupsionit dhe supersticionit, përtacisë dhe hipokrizisë, supremacionit të traditave dhe shprehive joislame, materializmin e përbetuar dhe mungesën shqetësuese të entuziazmit dhe shpresës. A mundet në gjendjen e këtillë drejtpërdrejt të fillojë çfarëdo transformimi shoqëror dhe politik?

Çdo popull para se është ftuar ta kryej rolin e vet në histori, medoemos është dashur të përjetojë periodën e pastrimit të brendshëm dhe pranimit praktik të disa qëndrimeve themelore morale.

Çdo fuqi në botë fillon si forcë morale, çdo humbje fillon si dështim moral. Çdo gjë që dëshirohet të sendërtohet, së pari duhet patjetër të sendërtohet në shpirtërat e njerëzve.

Ç'do të thotë rimëkëmbja fetare si parakusht i rregullimit islam? Ajo para së gjithash, do të thotë dy gjera: vetëdije të re dhe vullnet të ri.

Rimëkëmbja fetare është vetëdija e qartë mbi synimin e vërtetë të jetës, mbi atë për çka jetohet dhe për çka duhet të jetohet. A është ky synim standard personal apo i përbashkët, lavdia dhe madhësia e racës apo popullit tim, afirmimi i personalitetit vetjak apo pushteti i ligjit Hyjnor në tokë? Në rastin tonë rimëkëmbja fetare praktikisht, do të thotë "islamizimi" i njerëzve të cilët veten e quajnë muslimanë ose të cilët të tjerët rëndom i quajnë me atë emër. Pika nisëse e këtij "islamizimi" është besimi i fuqishëm në Zotin dhe praktika rigoroze dhe e sinqertë e normave

islame fetare dhe morale nga ana e muslimanëve. Komponenta tjetër e rimëkëmbjes fetare është gatishmëria që të zbatohet imperativi të cilin e imponon vetëdija mbi synimin. Për këtë shkak rimëkëmbja fetare është një kualitet i ngritjes dhe entuziazmit moral, një psikoze e supremacionit të shpirtit ndaj gjerave, një gjendje e idealizimit të përjetuar dhe praktik në të cilin njerëzit e rëndomtë bëhen të aftë për vepra të jashtëzakonshme të trimërisë dhe sakrificimit. Ajo është edhe një kualitet i ri i fesë dhe vullnetit në të cilën kriteret e përditshme të së munshmes pushojnë të vlejné dhe në të cilën individët dhe grupe të tëra befasisht ngriten deri te shkalla e flijimit për idealin e tyre.

Pa këtë gjendjen e re të shpirtit dhe të ndjenjës është e pamundur të arrihet çfarëdo ndërrimi i mirëfilltë në botën e sotme muslimane. Te këto shqyrtime gjithnjë, qoftë për një çast, do të shfaqet dilema, që rruga më e shkurtër deri te rregullimi islam do të shpiente nëpërmjet marrjes së sundimit, i cili më pastaj do të krijonte institucione përkatëse dhe do ta zbatonte edukimin sistematik fetar, moral dhe kulturor të popullit, si parakusht për ngritjen e shoqërisë islame.

Kjo dielmë është vetëm sprovë. Historia nuk njeh asnjë revolucion të mirëfilltë i cili ka ardhur nga pushteti. Çdonjëri ka filluar nga edukimi dhe në esencën e tij ka domethënie të thirrjes morale.

Përveç kësaj, formula e cila konstituimin e rregullimit islam ia beson njëfarë pushteti dhe institucioneve të tija, nuk përgjigjet në pyetjen prej kah vetë ai pushtet. Kush do ta konstitujë dhe kryej dhe prej cilëve njerëz ai dhe institucionet e tij do të përbëhen? Kush, më në fund, do ta kontrollojë, sjelljen e vet atij pushteti dhe si të sigurohet që ai mos të degjencrohet dhe mos të fillojë t'i shërbejë vetes në vend që t'i shërbejë synimit në emër të të cilit është konstituuar?

Është e mundur që një grup në pushtet të ndërrohet me tjetër, dhe kjo për çdo ditë po ndodh. shtë e mundur që tiraninë e, njërit ta ndërrosh me tiraninë e tjetrit dhe të kryhet ndërrimi i pronarit të të mirave të kësaj bote. Është e mundur të ndërrohen etmrat, flamujt, hymnet dhe parollat në emër të të cilëve e tërë kjo bëhet. Por, me këtë s'është e mundur të bëhet asnjë hap më afër rregullimit islam, si një ndjenjë e re e botës dhe qëndrimit tjetër të njeriut ndaj vetes, njerëzve dhe botës.

Mendimi që çdokund të thirret në ndihmë njëfarë fuqie ose njëfarë sundimi, rrënjën e ka në prirjen e lindur të njeriut që t'i shmanget fazës së parë dhe më të rëndë të xhihadit - luftës kundër vetëvetes. Vështirë është të edukohen njerëzit, por edhe më rëndë veten. Rimëkëmbja fetare, tashmë sipas përkufizimit të tij nënkupton fillimin nga vetëvetja, nga jeta vetjake. E kundërta, fuqiagjithnjë e ka parasysh tjetrin. Në këtë është tërheqshmëria e kësai ideje.

Për këtë arsye lëvizja, e cila si synim kryeso'r të vetin do ta theksojë rregullimin islam, duhet para së gjithash të jetë lëvizje morale. Ajo duhet pa tjetër moralisht t'i mallëngjëjë njerëzit dhe të paraqesë një funksion moral, e cilanjerëzit i ngre lartë dhe i bënë më të mirë. Në këtë është dallimi ndërmjet lëvizjes islame dhe partisë politike, e cila parashtron barabarësinë e mendimeve dhe interesit, por nuk i inkuadron kriteret etike, as që moralisht i angazhon njerëzit.

Qëndrimi mbi prioritetin e rimëkëmbjes fetare, përveç tjerash, ka edhe mbështetje të qartë në burimet islame.

E para, Kur'ani thotë se rilindja e brendshme është parakusht i çdo ndërrimi dhe përmirësimi të gjendjes së një populli (Kur'ani, 13,12)

E dyta, ky ligi është afirmuar edhe në praktikën e Islamit të bershëm dhe luftën e Muhammedit a.s. për konstituimin e rregullimit të parë islam në histori. Në këtë tregon fakti se Kur'ani gjatë trembëdhjetë viteve të para ka vazhduar të diskutojë dhe theksojë ekskluzivisht pyetjet e besimit dhe përgjegjësisë, dhe se gjatë këtyre trembëdhjetë viteve nuk i ka hyrë shqyrtimit të cilit do problem shoqëror ose politik apo formulimit të cilit do ligj të shoqërisë të mbështetur në Islam.

Nga rimëkëmbja fetare presim edhe tri gjera me rëndësi:

1. Vetëm rimëkëmbja fetare mund të krijojë vendosshmëri që urdhërat e Kur'anit, veçanërisht ato të cilat janë të drejtuara të këqiave të rrënjësura sociale ose janë jo të këndshme për pushtetmbajtësit dhe pronarët e pasurive, zbatohen pa hamendje dhe kompromise. Rimëkëmbja fetare mund të bëjë që ato të sendërtohen pa dhunë dhe urrejtje, sepse të gjithë, ose shumica e madhe e shoqërisë së rimëkëmbur, do t'i kuptojë dhe pranojë si zbatim i urdhërave të Zotit dhe si çështje e drejtësisë.
2. Rilindja Islame nuk mund të mendohet, jo vetëm pa njerëz të gatshëm në sakrifica të mëdha vetjake dhe materiale, por edhe pa shkallën e madhe të besimit reciprok dhe bashkëpunimit lojal. Çka mund të sigurojë që orvatjet, vetëm mohimi dhe sakrificat e disave të mos shfrytëzohen që të sendërtohet sundimi dhe ambicia e të tjerëve? Çka mund të pengojë që tragjedia e dështimit moral, aq e shpeshtë në historinë e re islame, mos të përsëritet? Çdo rregullim, e edhe ai islam, gjithnjë më shumë do të përngjasë në njerëzit të cilët e krijojnë dhe zbatojnë se sa në parimet të cilat ata i proklamojnë.
3. Për shkak të prapambetorisë së madhe, bota islame do të duhej pa tjetër të pranojë tempon shumë të shpejtë të arsimimit dhe industrializimit. Zhvillimi i shpejtuar çdokund është i ngarkuar

me fenomenet e atilla përcjellëse, siç janë: despotizmi, korrupcioni, shkapërderdhja e familjes, pasurimi i shpejtë dhe i paarsyeshëm, dalja në plan të parë i individëve të gjindshëm dhe të paskrupull, urbanizimi i shpejtë me heqjen e traditave, vullgarizimi e marrëdhënieve shoqërore me përhapjen e alkoholizimit, drogës dhe prostitucionit. Penda kundër këtij vërshimi të jokulturës dhe primitivizmit mund të jetë besinë e pastër dhe e fortë në Zotin dhe praktika e dispozitave fetare nga ana e të gjitha shtresave të popullit. Vetëm feja mund të sigurojë që qytetërimi mos ta zhdukë kulturën. Progresi i thatë material dhe teknik, sikur që këtë disa raste qartë e tregojnë, mund të shndërrohet në kthim të hapur në barbarizëm.

PUSHTETI ISLAM

Theksimi i prioritetit të rimëkëmbjes fetare-morale nuk do të thotë - as që mund të komentohet se do të thotë - se rregullimi islam mund të sendërtohet pa pushtet islam. Ky qëndrim do të thotë vetëm se rruga jonë nuk zë fill në të marrurit e pushtetit, por në të pushtuarit e njerëzve, dhe se rilindja islame është së pari kthesë në sferën e edukimit, e vetëm pastaj në sferën e pofitikës.

Medoemos duhet, pra, së pari të jemi predikues e pastaj ushtarë. Mjetet tona të para janë shembulli personal, libri, fjala. Kur këtyre mjeteve do t'i bashkangjitet edhe fuqia?

Zgjidhja e këtij rasti gjithnjë është pyetje konkrete dhe varet nga një varg faktorësh. Megjithatë mund të vëhet një rregull i përgjithshëm: lëvizja islame duhet dhe mund t'i afrohet marrjes së pushtetit posa moralisht dhe numerikisht të jetë aq e fuqishme sa të mund jo vetëm ta rrënojë

pushtetin ekzistues joislam, por edhe ta ndërtojë pushtetin e ri islam. Ky dallim është i rëndësishëm, sepse rrënimi dhe ndërtimi nuk kërkon shkallë të njëjtë të gatishmërisë paologjike dhe materiale.

Të hershosh këtu është barabartë rrezik sikur të vonohesh.

Të marrësh pushtetin në bazë të rrethanave fatlume beftëse, pa përgatitje të mjaftueshme morale dhe psikologjike, dhe pa minimumin e domosdoshëm të kuadrove të fortë e të ndërtuar, dù të thotë të sendërtosh edhe një grushtshtet, e jo revolucion islam (kurse grushtshteti është vazhdim i pofitikës joislame nga ana e grupit tjetër të njerëzve apo në emër të parimeve tjera). Të vonohesh në marrjen e pushtetit, do të thotë të privohesh nga një mjet i fuqishëm për sendërtimin e synimeve të rregullimit islam dhe pushtetit joislam, t'i ofrosh mundësi t'i shkaktojë goditje lëvizjes dhe t'i rrallojë kuadrot e tij. Për këtë të fundit, historia e paradokohshme ofron shembuj të mjaftueshëm, tragjik dhe instruktiv.

PAKISTANI - REPUBLIK ISLAME

Kur është fjala për pushtetin islam, shembulfi i Pakistanit, si republikës sot të vetme të deklaruar islame, nuk mund të bishtrohet.

Ne e përshëndetim Pakistanin, pa marrë parasysh në moseset dhe vështirësitë e caktuara, sepse ai është fryt i këtij synimi për konstituimin e rregullimit islam dhe sepse ata të cilët e kanë

menduar, sikur edhe ata të cilët e kanë sendërtuar kanë qenë të udhëhequr me mendimin e qartë islam.

Pakistani është provë gjenerale e vendosjes së rregullimit islam në kushtet bashkëkohore dhe në shkallën e sotme të zhvillimit. Në shembullin e Pakistanit, protagonistët e Islamit dubet dhe mund të mësojnë si duhet dhe si nuk duhet punuar.

Përvojën negative të Pakistanit - kurse përvojat negative janë gjithnjë më të rëndësishme - mund ta përmbledhim në këto dy pika:

1. Uniteti dhe krijueshmëria e pamjaftueshme e fuqisë themelore të organizuar e cila e ka jetësuar idenë e Muhammed Iksballit mbi Pakistanin. Së shpejti pasi është krijuar Pakistani, u tregua se Liga Muslimane ka tubuar elemente shumë të pabarabarta, të cilët nuk kanë pasur pikëpamje unike në pyetjet fundamentale të rregullimit të shoqërisë dhe organizimit të shtetit. Nga kjo anë Liga ka qenë mezi diç më shumë se partia politike e tipit klasik dhe para dilemave të mëdha para të cilave është gjetur Pakistani, ajo nuk ka mund ta mbajë unitetin e saj.

2. Hyrja formaliste dhe dogmatike sendërtimit të parimeve islame në praktikën e Pakistanit. Mendimtarët dhe juristët e Pakistanit, në vend që t'i kthehen pyetjeve të mëdha të arsimit, e kanë shterrë energjinë e tyre dhe përfundimisht janë ndarë në pyetjet e zbatimit më pak apo më shumë të përpiktë të të drejtës penale dhe martesore të sheriatit. Deri sa ata kanë zhvilluar diskutime të pafund mbi atë a t'i prehet dora vjedhësit ose thjeshtë të dërgohet në burg, një aspekt i veçant i vjedhjes - korrupcioni, ka marrë përmasa që s'mbahen mend dhe sollë deri te kriza, e cila i ka dridhur themelet e Pakistanit si shtet.

Mësimet nga ekzistimi njëzet vjeçar i Pakistanit janë të qarta. Ato janë:

E para, luftën për rregullimin islam dhe rekonstruimin themeltar (solid) të shoqërisë muslimane me sukses mund ta zhvillojnë vetëm individët e kalitur dhe të ngritur, të radhitur në organizatë të fortë dhe homogjene. Kjo organizatë nuk është kurrfarë partie politike nga arsenal i demokracisë perëndimore; ajo është lëvizje e mbështetur në ideologjinë islame dhe në kriteret e qarta morale dhe ideore të përkatësisë;

E dyta, lufta për rregullimin islam sot është lufta që të sendërtohet esenca e Islamit, e kjo do të thotë, që në praktikë të sigurohet edukimi fetar dhe moral i popullit dhe elementet themelore të drejtësisë shoqërore. Format në këtë çast kanë rëndësi dytësore; dhe

E treta, funksioni i republikës islame nuk është pikë së pari të deklarojë barabarësinë e njerëzve dhe vëllazërimin e të gjithë muslimanëve, por të luftojë të sendërtojë diç nga këto parimet e larta në praktikë. Islami i zgjuar duhet që në çdo mjedis të merrë në duart e tij flamurin e luftës për rregullimin më të drejtë shoqëror dhe që qartë ta theksojë që me luftën për Islam të fillojë edhe lufta kundër mosdijes, padrejtësisë dhe varfërisë, luftë në të cilën nuk do të ketë kompromise dhe zbythje, nëse këtë luftë e bënë, këtë flamur do ta marrin demagogët dhe shpëtuesit e rrejshëm të shoqërisë, që t'i sendërtojnë synimet e tyre hipokrite.

Këto mësimet kanë shije trishtimi. Ne megjithatë mbesim të besojmë në Pakistanin dhe në misionin e tij në shërbim të Islamit botëror. Sepse, nuk ka zemër muslimane e cila nuk do të dridhet gjatë të përmendurit të diçkajit aq të dashur siç është Pakistani, ndonëse kjo dashuri, sikur edhe çdo tjetër, di për tmerret dhe shqetësimet e veta. Pakistani është shpresa jonë e madhe, plotë sprovë. (Përsiatjet lidhur me Pakistanin duhet kuptuar në kontekstin kohor, v.p.).

PANISLAMIZMI DHE NACIONALIZMI

Në një nga tezat për rregullimin islam të të sotshmes, kemi theksuar se funksioni natyror i rregullimit islam është synimi për tubimin e të gjithë muslimanëve dhe të gjitha bashkësive muslimane në botë. Në rrethanat e sotshme ky synim do të thotë luftën për krijimin e federatës së madhe islame prej Marokos deri në Indonezi, prej Afrikës tropike deri në Azinë Qendrore.

Neve na është mirë e njohur se si përmendja e këtij vizioni e nevrikos një lloj të njerëzve në mjedisin tonë, të cilët veten e quajnë ose e konsiderojnë realist, dhe ne aq më qartë dhe zëshëm e theksojmë këtë synim. Ne e injorojmë këtë "realizëm" i cili popuit muslimanë i gjykon në pozitë të vazhdueshme inferiore dhe nuk i lë vend kurrfarë përpjekjeje dhe kurrfarë shprese. Ky realizëm, i cili burimin e ka në dekurajim dhe në respektim ndaj të fuqishmëve në botë, do të thotë se zotërinjt rmbesin zotërinj, kurse mëditësit - mëditës. Mirëpo historia është jo vetëm rrëfim mbi ndërrimin e përhershëm, por edhe mbi sendërtimin e vazhdueshëm të të pamundshmes dhe të papritures. Pothuaj, tërë çka e bënë njërnendësinë e botës bashkëkohore është dukur e pamundshme para pesëdhjetë vitesh.

Ekzistojnë qartë dy realizma: i yni dhe i dekurajuesve tonë dhe të dobëve. Neve na duket se nuk ka asgjë më të natyrshme, sandejmi as më reale, nga kërkesa që muslimanët t'i sendërtojnë format e ndryshme të unitetit për t'i zgjidhur problemet e përbashkëta dhe që suksesivisht t'i hyjnë krijimit strukturave të caktuara supranacionale - ekonomike, kulturore dhe politike - për arsye të veprimit të koordinuar dhe të përbashkët në disa sfera të rëndësishme. "Realistëve" (lexo: të dobtëve) tonë ky mendim u duket joreal. Ata e sanksionojnë gjendjen ekzistuese, e cila sërish, për të kuptuarit tonë të realizmit, paraqet shembull të diçka shumë jo të natyrshme e madje absurde.

Për ne, për shembull, është absolutisht e papranueshme dhe joreale që në epokën e sotshme të koncentrimit dhe bashkimit, një popull- ai arab - të copëtohet në trembëdhjetë bashkësi shtetërore; që në sërën e pyetjeve të rëndësishme botërore vendet muslimane qëndrojnë në anët e kundërta: që Egjiptit muslimanë mos t'i interesojë vuajtja e muslimanëve në Etiopi ose Kashmir; që në kohën e konfrontimeve më të ashpra të vendeve arabe me Izraelin, Persia muslimane mbanë marrëdhënie miqësore me agresorin, etj. etj. Nëse, pra, ekziston diç që nuk është reale, atëherë kjo nuk është unitet i muslimanëve, por mosprania e këtij uniteti, pikërisht gjendja e sotme e mosunitetit dhe e mospajtimit.

Nuk ekziston synim historik - përveç nëse është në kundërshtim me faktet natyrore apo historike - të cilin njerëzit me vullnetin e përbashkët dhe punën e përbashkët nuk do të mund ta sendërtonin. Utopia në të cilën besohet dhe për të cilën punohet pushon të jetë utopi. Kurse të dobët as që mund të besojnë, as që mund të punojnë, dhe në këtë duhet kërkuar shpjegimin e "realizmit" të tyre të degraduar. Kur ata thonë se uniteti i muslimanëve është ëndërr i cili nuk mund të sendërtohet, ata, në të vërtetë, vetëm e shprehin paaftësinë të cilën vetë e mbjellin. Kjo pamundësi nuk është në botë, por në zemrat e tyre.

Ideja mbi unitetin e të gjithë muslimanëve nuk është çpikje e askujt, as dëshirë e bukur e këtij apo atij reformatori ose ideologu. Atë e ka themeluar vetë Kur'ani me parollën e njohur "muslimanët janë vëllezër", kurse Islami vazhdimisht e ka mbajtur dhe përtëritur në vetëdijcn e njerëzve nëpërmjet agjërimit të përbashkët, vizitës së Mckkes, dhe Ka'bes si qendër unike shpirtërore, duke krijuar në këtë mënyrë një ndjenjë të përhershme dhe identike të përkatësisë dhe përbashkësisë përgjatë botës muslimane. Kush kurdoherë pas ndonjë fatkeqësie e cila e ka goditur

ndonjë popull të largët muslimanë, ka zbritur ndër njerëzit e rëndomtë, ka mundur të bindet çfarë ngarkese kanë këto ndjenja të dhimsurisë dhe solidaritetit.

Si po ndodh që ky "panislamizëm popullor", pa mëdyshje i pranishëm në aspekt të ndjenjave të fuqishme të masave të mbetet pa shumë ndikim në jetën reale dhe politikën praktike të vendeve muslimane? Pse ai mbetet velëm në gjendjen e ndjenjave dhe nuk ngritet deri në vetëdijen e duhur mbi latin e përbashkët? Si të shpjegohet fakti se lajmi mbi pësimin e muslimanëve, atyre në Palestinë, ose atyre në Krime, Sinkjang, Kashmir, Etiopi nxisin ndjenjën e dcpresionit dhe gjykimit njëzëri, e që njëkohësisht aksioni gjithnjë mungon ose ai është në disproporcion të plotë me atë çka ndihet?

Përgjigja në këtë pyetje gjendet në faktin që përkundër ndjenjave të popullit të rëndomtë, veprimi i vetëdijshëm i qarqeve udhëheqëse, të shkolluar në Perëndim ose nën ndikimin e perëndimit, kanë qenë jo panislamike, por nacionaliste. Instituti dhe vctëdija e popujve muslimanë kanë qenë të ndarë dhe të kundërshtuar, dhe në këtë gjendje çdo aksion i rëndësishëm ka qenë dhe do të jetë i pamundshëm.

Panislamizmi bashkëkohor sandejmi është pikë së pari përpjekje që vctëdija të harmonizohet me ndjenjat, që të duam atë që jemi dhe të mos duam atë që nuk jemi.

Kjo gjendje përcakton edhe karakterin edhe fatin e nacionalizmit në botën e sotme muslimane.

Deri sa çdokund në botë nacionalizmi ka pasur karakteristika të lëvizjes së gjërë popullore, sepse ka paraqitur afirmimin e synimeve popullore (melosit, folklorit e veçanërishtë gjuhës), në vendet

muslimane sipas rregullimit takohet një formë e atrolizuar e nacionalizmit, ose madje një lloj i nacionalizmit jopopullor, anacional.

Shpjegimin e këtui fakti duhet kërkuar nga një anë në faktin që ndjenjat popullore i ka absorbuar panislamizmi, kurse nga ana tjetër, çka këtu nacionalizmi është menduar si ndërrim për Islamin dhe si i tillë prej rillimit ka paraqitur lëvizje antiislame. Duke u gjetur në konflikt natyror me të kaluarën dhe traditat e popujve - sepse këto tradita janë gjithnjë dhe vetëm islame - lëvizjet nacionaliste ne një sërë vendesh muslimane vijnë në gjendje ta aplikojnë një lloj denacionalizimi, mjaft të ngjashme asaj të pararendësve të tyre kolonialistik. Pozita e gjuhës arabe, për shembull, në disa vende arabe - së paku sa i përket qëndrimit të administrimit - nuk është shumë më i përshtatshëm se sa gjatë kohës së okupacionit anglo-françez. Nëse në këtë aspekt diç edhe bëhet, ajo është pa entuziazëm të vërtetë, apo është vepër e fuqive të cilat nuk janë bastardhuar (krahaso. Hebraitët në Izrael e kanë futur pothuaj gjuhën e harruar hebraite). Shkaku për qëndrimin e këtillë kundruall gjuhës arabe është i thjeshtë: kjo gjuhë si gjuhë e Kur'anit dhe qytetërimit islam, më tepër është instrument i ndjenjave islamike se sa arabe, panarabe, përgjithësisht nacionaliste. Protagonistët e nacionalizmit saktë e vërejnë këtë fakt (ose më shumë instinktivisht e ndiejnë) dhe gjejnë dalje pa présidence: ata dhe administrata e tyre flasin me gjuhën e okupatorëve të hershëm (!). Në botën muslimane pa Islam nuk ka as patriotizëm.

Këto konkludime në mënyrën e vet i konfirmon edhe fakti se idetë nacionaliste në botën muslimane janë islame edhe sipas prejardhjes së tyre. Kjo është më e evidente në Lindjen e Mesme, ku pionierët e nacionalizmit janë intelektualët sirianë dhe të krishterët libanez, të shkolluar në Institutin Amerikan (në fillim: kolexhi Sirian protestantist) dhe në Univerzitetin e Shën Gjergjit në Bejrut. Të hulumtuarit e rrënjëve shpirtërore dhe historike të lëvizjes së Kemalit në Turqi, të

"pança shillës" së Sukarnos në Indonezi, partisë BAATH në disa vende arabe (veçanërisht disa rrymave të saja) dhe vargut të tërë të grupeve nacionaliste dhe "revolucionare" përgjatë botës muslimane, e konfirmon këtë konstatim. Panislamizmi gjithnjë ka buruar nga vetë zemra e popujve muslimanë, nacionalizmi gjithnjë ka qenë mallë i importuar.

Popujt muslimanë, pra, nuk kanë "prirje" për nacionalizëm. A duhet të dëshprohen lidhur me këtë fakt?

Madje edhe sikur për një çast ta mospërfillnin të vër tetën e qartë se parimi i bashkësisë shpirtërore është më superior prej parimit të kombit, do të duhej medoemos, duke e marrë parasysh çastin kur po e shkruajmë këtë mesazh, t'u këshillojmë popujve tonë që edhe mos të orvaten ta ngadhëjnë këtë "aftësi". Edhe nga popujt të cilët me shekuj jetojnë në bashkësitë nacionale ardhmëria kërkon që shkallërisht t'u përshtaten formave të reja të jetës së përbashkët, të cilat mundësojnë tubimin në bazë të gjerë. Njerëzit largpamës në Francë dhe Gjermaninë e sotshme u këshillojnë bashkëqytetarëve të tyre që më pak të ndihen Francezë ose Gjermanë e më shumë Evropianë. Themelimi i Bashkësisë Ekonomikë Evropiane - ndonëse ky konfirmim në shikim të parë mund të duket i papranueshëm - paraqet ngjarjen më konstruktive të historisë evropiane të shekullit XX. Kurse krijimi i kësaj strukture mbinacionale është fitorja e parë e vërtetë e popujve evropianë mbi nacionalizmin. Nacionalizmi po bëhet luksuz, shumë i shtrenjtë për popujt e vegjël, e madje edhe për popujt e mesëm të mëdhenj.

Bota bashkëkohore gjendet para zhvillimit, i cili në njëfarë aspekti është pa krahasim në histori. Me programet e tyre jashtëzakonisht të shtrenjta të arsimit, hulumtimit, ekonomisë, mbrojtjes e tjera, ky zhvillim kërkon koncentrimin deri tash të pa mbajtur mend dhe të papritur të njerëzve

dhe të mjeteve dhe objektivisht u jep rast vetëm popujve të mëdhenj, ose edhe më qartë, lidhjeve të popujve. Në botë momentalisht sundojnë dy unione - amerikane dhe sovjetike kurse e treta në procesin e krijimit - evropiane, gjithnjë e më qartë e paralajmëron daljen e saj në skenë. Bashkësia e cila nuk mund t'i tubojë 200 milionë banorë dhe t'i krijojë 200 miliardë dollarë të ardhura nacionale - kurse këto madhësi kanë tendencë rritjeje - nuk mund ta mbajë hapin në këtë lëvizje dhe patjetër do të duhej të pajtohet me pozitën e varur. Ajo nuk mund të reflektojë jo të sundojë me të tjerët, por as të sundojë me vetëveten. Shkalla e zhvillueshmërisë pushon të jetë faktor vendimtarë. Atë e ndërrojnë madhësitë absolute. Kina sipas zhvillimit të saj qëndron konsiderueshëm pas Francës ose Anglisë, por duke iu falënderuar koncentrimin ië madh të njerëzve dhe mjeteve, ajo në lojën rrjedhëse tregon supremacionin shprehës. Kjo situatë paraqet rastin për botën muslimane, e cila nuk është e zhvilluar, por është e madhe.

Ekziston edhe një çështje e cila në mënyrë alarmante thërret në tubim dhe në përpjekjet e bashkuara të ve ndeve muslimane.

Prapambeturinë ekonomike dhe kulturore të vendeve muslimane nga dita në ditë e keqëson fenomenin e rritjes së vrullshme të popullësisë. Dy vendet muslimane - Egjipti dhe Pakistani - momentalisht mbajnë dy vendet e para në shkallën e natalitetit në botë. Sipas disa parashikimeve, çdo vit në botë lindin 20 milionë muslimanë dhe nëse rritja vazhdohet me këtë tempo, bota muslimane në kufinjt ekzistues do të dyfishohet deri në fund të këtij shekulli. A mund t'i pranojmë, ushqejmë, shkollojmë dhe të hapim vende pune për aq miliona të cilët presin që të lindin? Ky zhvillim dramatik demografik , nëse nuk do të përcillet me zhvillimin gjithashtu të shpejtë ekonomik dhe shoqëror, është përplotë rreziqesh dhe pasigurish potenciale. Për 20 vitet e kaluara ky "inflacion demografik" kryesisht e ka absorbuar tërë rritjen e produktivitetit, ashtu që

në shumicën e vendeve muslimane të ardhurat nationale për njëri sot janë më të vogla se sa para dy dekadave. Ashtu rritja e popullësisë, në vend që të jetë faktor i fuqisë në botën e bashkuar muslimane, po bëhet burim i krizave dhe dëshprimeve për vendet e përçara muslimane.

Është e qartë se vendet muslimane nuk mundën individualisht të dalin në krye me këtë problem. Të ballafaqohemi me këtë situatë dhe njëkohësisht të kompezohen dekadat e humbura të prapambetjes dhe stagnimit mundemi vetëm nëpërmjet këtij kualitetit të ri - unitetit. Atë që nuk mund ta zgjidhin vetë Arabët, Turqit, Persianët ose Pakistanezët nund ta zgjidhin muslimanët në një përpjekje e cila do të jetë e përbashkët dhe e koordinuar.

Çdo vend muslimanë mund ta ndërtojë lirinë dhe mirëqenien e tij vetëm nëse me këtë e ndërton lirinë dhe mirëqenien e të gjithë muslimanëve. Kuvajti dhe Libia e pasur nuk mund të ekzistojnë si ujdhesa të mirëqenies në detin e mjerimit. Nëse nuk e krijojnë solidaritetin islam dhe nuk i ndihmojnë vendet fqinje muslimane, nëse udhëhiqen me egoizëm, a nuk do t'i përudhim këto vende në sjellje te ngjashme? Kurse kjo do të shpiente në gjendjen e urrejtjes dhe kaosit, të cilën e dëshirojnë armiqtë. Duke e kryer detyrën e tyre islame, vendet e pasura muslimane do ta kryejnë edhe atë çka kërkon interesi i tyre më i lartë.

Alternativa para çdo vendi muslimanë është e qartë: ose i bashkuar me vendet tjera muslimane të sigurojë ekzistimin, përparimin dhe fuqinë që të ballafaqohet me çdo sprovë, ose nga dita në ditë gjithnjë e më shumë të mbetemi mbrapa dhe të bijmë në varshmëri nga të huajt e pasur. Çasti bashkëkohor historik këtij uniteti i jep dimension të ri: ai nuk është më vetëm dëshirë e mirë e idealistëve dhe vizionaristëve: uniteti është bërë domosdoshmëri, nevojë e shtërngueshme, ligj i

ckzistimit dhe kusht i denjësisë në botën e sotme. Ata të cilët për çfarë do shkaqesh dhe motivesh e përmbajnë ndasinë e sotme, praktikisht janë në anën e armikut.

Instinkti panislam i masave muslimane përkryeshmërisht pajtohet me këtë imperativ të situatës historike. Edhe këtu përparimtarët janë ata të cilët me nacionalizmin e tyre nuk shohin asgjë

KRISHTERIZMI DHE HEBRAIZMI

Duke e marrë parasysh hapësirën, në këtë tekst nuk është e mundur të shtrohet raporti i Islamit ndaj të gjitha doktrinave dhe sistemeve më të rëndësishme jashtë sferës së Islamit. Megjithatë, është e domosdoshme të shtrohet ky raport ndaj dy religjioneve më të rëndësishme: krishterizmit dhe hebraizmit dhe ndaj dy sistemeve sunduese botërore shoqërore: kapitalizmit dhe socializmit.

Në pyetjen e raportit ndaj krishterizmit, ne dallojmë diturinë e Jezu Krishtit nga Kisha. Në të parën shohim shpalljen e Zotit, në disa pika të shtrembëruar, kurse në të dytën një organizatë, e cila me hierarkinë, politikën, pasurinë dhe intereset e veta të pashmangshme, është bërë jo vetëmjoislame, por edhe antikrishtere. Çdokush kush duhet ta përcaktojë qëndrimin e vet ndaj krishterizmit, kërkon që t'i përkufizohet: a është fjala për diturinë e Jezu Krishtit ose për inkuizicionin, kurse kisha në të jetuarit e saj historik gjithnjë ka bredh ndërmjet këtyre dy poleve. Sa më shumë kisha të jetë shprehje dhe shpjegim i mësimave etike të Uligjellit, ajo është larg prej inkuizicionit, dhe me vetë këtë afër Islamit. Tendencat e reja në kishë, të cilën e ka deklaruar koncili i fundit i Vatikanit, ne i përshëndesim sepse i vlerësojmë si njëfarë afrimi bazave origjinale

të krishterizmit. Nëse këtë të krishterët do të donin, ardhmëria mund të ofrojë shembuh të mirëkuptimit dhe bashkëpunimit të dy religjioneve të mëdha për të mirën e të gjithë njerëzve dhe njerëzisë, ashtu siç ka qenë e kaluara arenë e padurimësisë dhe grindjes së tyre të pakuptimtë.

Në parimin e ngjashëm zë fill qëndrimi i Islamit ndaj hebraizmit. Me Hebraikët me shekuj kemi jetuar së bashku dhe madje kemi krijuar kulturë, ashtu që në disa raste nuk mundet me siguri të ndahet çka në atë kulturë është islame, e çka hebraiste.

Mirëpo, nën udhëheqjen e Cionistëve, Hebraikët në Palestinë e kanë filluar aksionin i cili është barabartë johuman dhe i pa skrupull, sa edhe shkurtëpamës dhe avanturistik. Kjo politikë merrë në llogari vetëm gjendjen momentale dhe...të përkohshme të raporteve, kurse i harron faktorët e perhershëm dhe marrëdhëniet e përgjithshme të fuqive ndërmjet Hebraikëve dhe muslimanëve në botë. Ajo në Palestinë i ka provokuar të gjithë muslimanët e botës. Jerusalemi nuk është vetëm pyetje e Palestinezëve, as vetëm e Arabëve. Kjo është pyetje e të gjithë popujve muslimanë që ta mbajnë jerusalemin, Hebraikët do të duhej ta ngadhënjë Islamin dhe muslimanët, kurse kjo - falënderimi i qoftë Zotit - gjendet jashtë fuqisë së tyre. Ne do të dëshironim t'i dallojmë Hebraikët nga cionistët, nëse vetë Hebraikët gjejnë fuqi ta tërheqin këtë dallim. Të shpresojmë se fitoret ushtarake, të cilat i kanë shënuar kundër regjimeve të përçara Arabe Go kundër Arabëve dhejo kundër muslimanëve), krejtësisht nuk do të na turbullojë arsyen dhe se do t'i hyjnë eliminimit të konfrontimit të cilin e kanë krijuar vetë, në mënyrë që t'i hapet rruga jetës së përbashkët në trollin e Palestinës. Nëse ata megüthatë e ndjekin rrugën në të cilën i shpie mendjemadhësia e tyre, çka tash për tash duket më e besueshme, për lëvizjen islame dhe të gjithë muslimanët në botë ekziston vetëm një zgjidhje: të vazhdohet lufta, të zgjerohet dhe të zgjatet, nga dita në ditë, nga viti në vit, pa marre parasysht në sakrificat dhe kohën sa do të mund të zgjatet

ajo, deri atëherë sa ata nuk do të jenë të detyruar ta kthejnë çdo hap të tokës së riëmbyer. Çfarëdo pazarllëku ose kompromisi, të cilët mund t'i sjellin në pyetje këto të drejta clementare të vëllezërve tonë në Palestinë, paraqet tradhti e cila mund ta rrënojë edhe vetë sistemin moral në të cilin zë fill bota jonë.

Këto qëndrime nuk janë shprehje e kurrfarë politike të re të Islamit ndaj të krishterëve dhe hebraikëve e cila do të ishte e diktuar nga rrethanat momentale. Ata në të vërtetë janë vetëm rezultat praktik i nxjerrur nga parimi islam mbi pranimin e krishterizmit dhe hebraizimit dhe rrjedhin pothuaj tekstualisht nga Kur'ani. (Kur'ani: 29, 45; 2, 136; 5, 47-49).

KAPITALIZMI DHE SOCIALIZMI

Në çfarë formash strukturale dhe trajtash politike do të manifestohet dhe sendërtohet rilindja islame e epokës sonë? A vlejnë disa trajta të organizimit të shtetit dhe shoqërisë, karakteristike për trevën e qytetërimit perëndimor - demokracia përfaqësuese, kapitalizmi, socializmi - edhe për shoqërinë islame, dhe a do të duhet pa tjetër edhe shoqëria detyrimisht të kalojë nëpërmjet kësaj dhe reformage të ngjashme?

Në dy shekujt e fundit në botë ishte rrënjosur bindja se çdo vend duhet pa tjetër të përjetojë kthesë kah demokracia përfaqësuese. Zhvillimi më i ri, e posaçërisht ndërmjet dy luftërave të mëdha, i ka afirmuar disa fakte të kundërta dhe ka treguar se demokracia klasike nuk është stadio i pashmangshëm në evolucionin e bashkësisë shoqërore dhe politike. Në menyre të ngjashme,

disa sot përpiqen të dëshmojnë se socializmi është orientim i domosdoshëm me të cilin , dashtë e pa dashtë, lëvizin shoqëritë njerëzore. Zhvillimi bashkëkohor i të ashtuquajturave vendeve kapitaliste në Evropë dhe Amerikë, ndërkaq i demantojnë mjaft qartë këta predikues të domosdoshmërisë historike dhe tregojnë në disa drejtime të reja, të papritura të zhvillimit. Në skajin tjetër të botës, në Japoni, nga ekonomia feudale drejtpërdrejt u kalua në atë çka në Evropë do të quhej formë më e lartë e kapitalizmit monopolist. Skemat të cilat i kanë krijuar njerëzit që ta sistematizojnë zhvillimin historik, janë treguar si mjaft relative, kurse ligjësitë në zhvillimin e shoqërisë, ndonëse ekzistojnë, dukshëm nuk janë të asaj natyre çfarë na kanë përshkruar mendimtarët evropian të shekullit XVIII dhe XIX.

Ky determinizëm i imagjinuar e ka shtrënguar ndërgjegjjen e brezevetëfundit, kurse përveç kësaj është eksploative edhe si mjet i fuqishëm psikologjik për përhapjen e ideve. Në të vërtetë, sistemi ndikon në gjendjen e një vendi vetëm aq sa që me më pak apo me më shumë sukses nxitë ose drejtpërdrejt e organizon punë i cili është burim i njëmendët i tërë pasurisë.

Të çliruar nga psikoza e domosdoshmërisë historike dhe duke iu falënderuar pozicionit të mesëm të citin e merrë Islami, ne mundemi pa paragjykime t'i shqyrtojmë anët e mira dhe të këqia të sistemeve ekzistuese, jo më tej si kapitalizëm dhe socializëm, por si praktikë e caktuar e shoqërive bashkëkohore në botën e sotshme.

Forma të pastërta dhe kapitalizmit dhe socializmit më nuk ekzistojnë askund. Zhvillimi i shpejtuar pas luftës së dytë. botërore i ka lënë larg pas vetes. Vetëm ekonomia e gurëzuar marksistike ekonomike, e cila gjithnjë e më pak është shkencë, kurse gjithnjë e më shumë shërbëtoare e politikës, vazhdon t'i përsërisë konstatimet rillestare, sikur në botë në pesëdhjetë

vitet e fundit nuk ka ndodhur asgjë. Duke gjykuar në bazë të shumë simptomeve të rëndësishme, kriteret klasike të "kapitalistes" dhe "socialistes" së shpejti do të bëhen absolutisht jopërkatese për shënimin e fenomeneve ekonomike dhe shoqërore në fazën e zhvillimit e cila vijon drejtpërdrejt.

Duke mos u përkulur, pra, para parollave dhe emërtimeve dhe duke i marrë parasysh vetëm faktet siç i shohim në botë, ne duhet pa tjetër ta pranojmë evolucionin e jashtëzakonshëm të botës kapitaliste në tridhjetë vitet e fundit, dinamizmin e tij, aftësinë e ta vë në lëvizje ekonominë dhe shkencën dhe të sigurojë shkallë të lartë të lirive politike dhe sigurisë juridike, sikur që nuk mundemi t'i injorojmë të arriturat e sistemit socialiste veçmas në sferën e mobilizimit të burimeve materiale, në fushën e arsimimit dhe në eliminimin e formave klasike të varfërisë.

Poashtu, ne nuk mund t'i harrojmë anët e errëta dhe të papranueshme të përparimit të tyre dhe krizat e thella të cilat kohë pas kohe i trondisin të dy këto sistemet..

Çiltëria pragmatike e Islamit në zgjedhjen e çështjeve të rregullimit të botës, kjo sot do të thotë përparësi që pa paragjykime të studiohen dhe përdoren përvojat pozitive dhe negative të tjerëve, para së gjithash, SHBA-ve, BRSS-së dhe Japonisë. Këto tri vendet paraqesin, parimisht dhe praktikisht, tri hyrje të ndryshme të zgjidhjes së pyetjeve themelore të mirëqenies dhe fuqisë.

Zhvillimi i kapitalizmit tridhjetë viteve të fundit ka treguar pasaktësinë e disa tezave themelore të marksizmit. T'i përmendim këtu tri:

1. Kundërthënia ndërmjet forcave prodhuese dhe raporteve prodhuese në kapitalizëm nuk është treguar e domosdoshme. Kapitalizmi jo vetëm që e ka ngadhjnyer këtë kundërthënie, por ka

mundësuar zhvillim dhe hov deri atëherë të papashëm të prodhimit, diturisë dhe produktivitetit të punës.

2. Klasa punëtore në vendet kryesore kapitaliste nuk ka shkuar rrugës revolucionare, dhe;

3. Raporti ndërmjet qenies dhe vetëdijes, "bazës" dhe "superstrukturës", nuk është i atillë siç e ka pohuar atë Marksi. Ne kemi kapitalizmin në Suedi dhe kapitalizmin në Argjentinë. Ndryshimet në bazë në këto vende janë ndryshimet në shkallë (të dyjat janë kapitaliste); ndryshimet në superstrukturat e tyre (format e pushtetit politik, ligjet, regjionin, filozofinë dominuese, artin e të ngjashme) janë ndryshime në esencë.

Në bazë të të gjitha këtyre zhvillimi në botë nuk ka shkuar rrugës të cilën e ka trasuar Marksi. Vendet përparimtare e kanë mbajtur dhe më tej e kanë zhvilluar kapitalizmin, kurse socializimi ka ngadhjyer në një varg vendesh të pazhvilluara, çka nga botëkuptimi mirksist është anomali e pashpjegueshme.

Me çka duhet të komentohet interesi i vendeve të pazhvilluara për disa forma të ekonomisë socialiste?

Para së gjithash, kjo formë e ekonomizimit tregohet më e dobishme për organizimin e ekonomisë ekstenzive, në të cilën janë përdhur vendet të cilat nuk kanë kurrfarë bazashi në atë kuptim çka nuk kanë kapital, quadro ekspertësh, shprehje të zhvihuara të punës e të ngjashme.

E dyta, mjedisi më i prapambetur më lehtë pajtohet me kufizimet e ndryshme (me zvogëlimin e lirisë personale, centralizmin, pushtetin e fortë e të tjera) të cilat gjithnjë e përcjellin disa tipa të socializmit, dhe;

E treta, edhe pse është tejkaluar si dituri, socializmi ka mbetur i gjallë si mit dhe aventurë. Kjo formë mjaft e rëndësishme e socializmit nuk i shpjegon vetëm shkaqet e ndikimit të tij shprehimisht më të madh në vendet katolike dhe romane në krabasim me vendet protestante dhe germane.

Përkundrazi, fryma pragmatike e kapitalizmit më mirë i përgjigjet racionalizmit të shoqërisë së zhvilluar. U tregua se format e zhvilluara të ekonomisë kapitaliste me sukses funksionojnë në shoqëri me format demokratike të pushtetit, me nivelin e lartë kulturor të mjedisit dhe me shkallën e lartë të lirive personale dhe politike. Përbri këtyre kushteve mundet madje në masë të konsiderueshme të neutralizohen disa aspekte johumane të ekonomisë kapitaliste, pa zvogëlimin qenësor të efikasitetit të saj.

Nuk ka, pra, asgjë nga domosdoshmëria e trilluar e këtij apo atij sistemi. Ajo çka me të vërtetë është e domosdoshme, ajo është të lëvizurit e pëndërprerë të ekonomisë, të zënë fdl në përparimin e përhershëm të shkencës dhe teknikës. Përkryerja e veglave dhe procesit të punës është, si duket, aktivitet i vetëm në këtë suazë, të cilën njerëzit "duhet pa tjetër" ta punojnë.

Sandejmi, para Islamit, sikurse edhe para botës përgjithësisht, nuk shtrohet dilema: kapitalizmi ose socializmi - dilema e atillë është e trilluar dhe artificiale - por pyetja e zgjedhjes dhe përkryerjes së përhershme të një sistemi të raportit të pronësisë dhe prodhimit i cili në mënyrë efikase dhe në pajtim me botëkuptimet islame të drejtësisë shoqërore, në mënyrën më të mirë do ta stimulojë punën dhe aktivitetin dhe t'i zgjidh problemet, që zhvillirni i pashmangshëm i prodhimit dhe teknikës i imponon.

PËRMBYLLJE

Këto janë disa nga idetë kryesore dhe hamendjet qenësore të rilindjes Islame, e cila në vetëdijen e njerëzve gjithnjë e më shumë merrë domethënien e transformimit të përgjithshëm të popujve muslimanë – atë moral, kulturor dhe politik. Midis të gjithave humbjeve dhe dëshpërimeve, rilindja islame është emër për shpresën dhe dalje në territor të gjërë të botës.

Asnjë muslimanë për të cilin përkatësia Islamit nuk është e kulluar, por program dhe obligim, nuk mund të refuzojë këtë vizion, por shumica në hamendje do të pyesin: ku janë forcat të cilat këtë vizion do ta sendërtojnë.

Duke u përgjigjur në këtë pyetje të pashmangshme, ne tregojmë në brezin e ri Islam, i cili po ngritet këtyre viteve. Ky brez prej njëqind milionë të rinjsh dhe vajzash, i lindur në Islam, i rritur në trishtimin e humbjes dhe nënçmimit, i unjesuar në patriotizmin e ri Islam, i cili do të refuzojë të jetojë nga lavdia e hershme dhe ndihma e huaj dhe i cili do të tubohet rreth synimeve që do të thonë të vërtetën, jetën dhe dinjitetin – mbanë në vete forcën e cila mund ta sendërtojë këtë ndërmarrje të pamundur dhe ballafaqohet me të gjitha sprovat.

Ky brez nuk ka mundur të shfaqet më heret. Është dashur që deri në fund të jetohej epoka e iluzioneve dhe lajthitjeve, që të tregohet paaftësia e zotërave të rrejshëm, etërve të ndryshëm të atdheut dhe shpëtuesve të shoqërisë, mbretërve dhe mehdive, që të na fitojnë në Sinajë që ta rrezikojnë Indonezinë, që ta trondisin Pakistanin, që të flasin shumë për lirinë, mirëqenjen dhe progresin, kurse ta sendërtojnë vetëm tiraninë, varfërinë dhe korrupsionin – e tërë kjo ka qënë e nevojshme që të vie koha e zhdukjes dhe që të lindet brezi të cilit i është e qartë se e tërë ka qënë

lajthitje e kotë dhe se për botën islame ekziston vetëm një dalje: t'u'kthehën burimeve vetjake, shpirtërore dhe materiale, çka do të thotë kjo, Islamit dhe muslimanëve. Bota e sotme islame është laramani e shkëlqyeshme e popujve, rasave, ligjeve dhe ndikimeve, por është një çeshtje e cila në çdo kënd të asaj bote takohet me respektin dhe lojalitetin e barabartë: Kur'ani, dhe një ndjenjë e cila është e barabartë në Javë, në Indi, Algjeri ose Nigjeri: ndjenja e përkatësisë bashkësisë së përgjithshme islame. Këto dy lojalitete në gjendjen e ndjenjave elementare të miliona njerëzve të rëndomtë përmbajnë rezerva të energjisë qetësuese dhe paraqesinb atë çka është e njëjtë dhe e barabartë në botën e sotme muslimane. Sipas tyre bota muslimane qysh tash është bashkësi e mirëfilltë emocionale me përmasa botërore, mbase bashkësia e vetme shumënacionale emocionale (jo edhe e organizuar) në botë.

Si pjesë përbërëse e këtyre ndjenjave dhe si rezultati i ndikimit të gjatë të etikës islame, në çdokund në këtë botë, në formë të urtësisë popullore, gjejmë nocione të gjalla mbi barabarësinë e njerëzve, drejtësinë shoqërore, durimësinë dhe merhametin kundruall çdo gjëse çka jeton. Këto fakte nuk do të thonë vetëvetiu botë më të mirë dhe më humane, por do të thonëpremtim i një bote më të mirë dhe më humane.

Ndjenjat për të cilat është fjala, tregojnë se bota muslimane është e gjallë, sepse atje ku është dashuria dhe dhimsuria, nuk është vdekje por jetë. Bota islame nuk është shkretëtirë; Ajo është ledinë e palëruar e cila i pretë lëruesit e saj.

Duke iu falenderuar këtyre fakteve, detyra jonë bëhet reale dhe e mundshme. Ajo përbëhet në atë që këto ndjenja, të cilat tash janë forca potenciale, t'i shndërrojmë në forca aktive. Lojaliteti ndaj Kur'anit duhet rritur në vendosshmërinë që ai të zbatohet; bashkësia emocionale islame duhet të

shndërrohet në bashkësi të organizuar, të vetëdijshme, kurse humanizmi popullor në ide të qarta, të cilat do të bëhen përmbajtje morale dhe sociale të ligjeve dhe institucioneve të ardhshme.

Kush dhe si do ta kryej këtë transformim?

Çdo veprim në ndodhi është veprim shoqëror. Çdo luftë e suksesshme është vetëm luftë e përbashkët, e organizuar. Brezi i ri do të mund ta kryej detyrën e vet të transformimitvetëm nëse synimet dhe idealizmi i tyre të jenë të shndërruara në lëvizje të organizuar, në të cilin entuziazmi dhe vlera personale e individëve do të jenë të bashkuar me metodat e veprimit të koordinuar dhe të përbashkët. Krijimi i kësaj lëvizjeje me synim dhe programin unik themelor, tregohet si kusht i parevokueshëm dhe pikënisëse e rilindjes në çdo vend muslimanë.

Kjo lëvizje do t'i tubojë të ngriturit, edukojë të pangriturit, do t'i ngrisë dhe thërras, përkufizojë synimet dhe gjejë rrugët deri te ata. Ajo gjithkund do të fusë jetë, mendim dhe aksion. Ajo do të bëhet ndërgjegje dhe vullnet i një bote pas gjumit të gjatë dhe të thellë.

Duke ia drejtuar këtë mesazh të gjithë muslimanëve të botës, qartë theksojmë se nuk ka vend të premtuar, çudibërësa as mehdi. Ekziston vetëm rruga e punës, luftës dhe sakrificës.

Në çastet e sprovave gjithnjë t'i kemi në mend dy çështje: pas nesh qëndron bekimi i Zotit dhe pëlqimi i popullit tonë.